

# Dukagjini "Nderi i Kombit"



# Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XVIII i botimit, nr. 215, Shtator 2021

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro


## NJË LIBËR I VEÇANTË NGA FORMA E PËRMBAJTJA **2**

Me datën 4 shtator 2021, në mjediset e Bibliotekës së Universitetit "Luigj Gurakuqi" u zhvillua veprimtaria e promovimit të librit, me titull "Kujtimet e një ushtaraku", të autorit kolonel Ndue Sanaj, në pension dhe kryetari i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini". Për situatën e pandemisë, një pjesëmarrje e kënaqshme dhe me masa kundër pandemisë, intelektual, ish ushtarak të lartë, studiues, botues, të cilat ia rriten vlerën e kësaj veprimtarie.



## KOLË PROGNI - SHQIPJA E ALPEVE SHQIPTARE

- mbresa nga një  
veprimtari -



Kaloi mbi një vit që Kolë Progni kaloi në amshim. U ngjit atje lart, në qiell, plot krenari për jetën e tij toksore, ashtu siç dinë të ngjiten burrat me mend. Se kur na vjen kjo ditë nuk e dimë, dhe mirë që nuk e dimë, por për këtë ditë duhet të përpiqemi dhe përgatitemi vazhdimisht. Kështu bëri dhe ja arriti, profesori i nderuar Kolë Progni. Nuk e donim, asnjë besoj, që të vinte kjo ndarje kaq pa prituri, kaq e shpejt dhe pa pasur mundësi që ti bëhej një përcjedhje e merituar, ti hillej një grusht dhe mbi arkemortin në banesën e fundit të tij.

**11**

## Vaksinimi kundër Covid-19, disa përgjigje për çështjet që shtrohen, kur hezitoni të bëni vaksinën

Pas variantit Delta (D), tani Evropa po përballon dhe me varantin e ri Kolumbian Kapa (K), ose MU (3 rastet e vërtetuara në një Azil pleqsh në Belgjikë) raportohet se ka raste dhe në Greqi. Si në gjithë Evropën dhe në vendin tone, që 15 korrik 2021 është vendosur nga ekspertet infeksionist dhe Ministria e Shëndetësisë, që i gjithë kontingjenti e popullsisë mbi 18 vjeç të futet në skemën e vaksinimit Ati-Covid-19- dhe 30% e popullsisë ka bërë të paktën 1 doze. Tani po ndalemi në disa çështje më të përgjithshme, të cilat na çojnë në refuzimin (hezitimin) e vaksinimit, ose për zgjedhjen...

**13**

## U NDA NGA JETA Mhill ÇUN GJONAJ, KRYERAPSODI I DUKAGJINIT

Me datën 10 shtator 2021, dite e Premte pushoj zemra e Kryerapsodit të Dukagjinit, Mhill Çun Gjonaj. Një vdekje e parakohshme, por kjo është jeta! Me datën 11 shtator 2021, në mjediset e Bar-Restorant "Orlando" u bë ceremonia e varrimit të tij, e përcjelljes për në banesën e fundit.

Në ceremoninë e varrimit ishin të pranishëm familjarë miq dhe koleg të Mhillit. Në emër të Shqoptës Atdhetare "Dukagjini", kryetari, Ndue Sanaj e N/kryetari, Prele Milani vendosen kurore pranë arkivolit të Mhill Çunit. Në emër të Shoqatës Atdhetare Dukagjini mbajti fjalën mortore, kryetari i saj z Ndue Sanaj. Në emër të kolegëve këngëtarë dhe rapsodëve fjalën mortore z. Kadri Fikaj.



## MË MIRË VONË SE KURRË

Më në fund pas 85 vitesh u pa asfalti në qendër të fshatit Theth. Një pritje e gjatë, por më mirë vonë se kurrë!!! Duket se ju erdhi fundi udhëtimeve të stërmunduara për banorët e Thethit e të gjithë Dukagjinit. Por edhe për mijëra e mijëra turist vendas e të huaj, të cilët vizitojnë këtë perlë të mahnitshme. Jo me kot Thethin e vizitonin shumë turist edhe kur nuk ishte ndërtuar asnjë automobilistike.

**7**



# NJË LIBËR I VEÇANTË NGA FORMA E PËRMBAJTJA

Me datën 4 shtator 2021, në mjediset e Bibliotekës së Universitetit “Luigj Gurakuqi” u zhvillua veprimtaria e promovimit të librit, me titull “Kujtimet e një ushtaraku”, të autorit kolonel Ndue Sanaj, në pension dhe kryetari i Shoqatës Atdhetarë “Dukagjini”.

Për situatën e pandemisë, një pjesëmarrje e kënaqshme dhe me masa kundër pandemisë, intelektual, ish ushtarak te larte, studiues, botues, te cilat ia rriten vlerën e kësaj veprimtarie.

Drejtoi këtë veprimtari anëtarja e kryesisë, zonjusha Klodjana Serraj, e cila pasi prezantoi temën e kësaj veprimtarie dhe ju uroj pjesëmarrësve mirëseardhjen, i dhuroj autorit te librit një buqete me lule.

Ne këtë veprimtari ligjëruan plote nga pjesëmarrësit, që vlerësuan maksimalisht punën me shumë përkushtim e vullnet, për grumbullimin e sistemimin e fakteve e argumenteve dhe mbi të gjitha realizmin, gjithë përfshirjen e aktorëve ushtarak e civil dhe në veçanti kulturën e gjerë të autorit, si nga ana historike, gjuhësore e letrare, gjeografike e domosdo profesionale ushtarake. Mbi të gjitha ndërthurjen e dukurive e ngjarjeve në libër, të cilat e bëjnë atë të nevojshme e të domosdoshme për njohjen e realitetit të kohës, kur zhvillohen e përshkruhen ngjarjet.

Kolonel **Flamur Muca**, ish komandanti i Divizionit në Shkodër dhe konsulent i autorit, ne mes te tjerave u ndal: “Tashme i pajisur me njohuri më të plota, me një vizion më të gjere, me koncepte të qarta të komandimit e të drejtimin do të caktohet në detyrën e komandantit të batalionit, në atë të shefit të shtabit të Brigadës Sulmuese Shkodër, të Brigadës 30 Këmbësore Vau e Dejës dhe në maj 1979, Ndoja emërohet komandant i Brigadës të 65 Këmbësore Has (Krume) të Korpusit të Pukës, një detyre tepër e rëndësishme. Janë vite intensive për Ndojen dhe koleget e tij, që arrijnë të konsolidojnë brigadën në përgatitjen luftarake, në rritjen e forcimin e gatishmërisë, në plotësimin e pajisjes fortifikuese të brezit të mbrojtjes, në krijimin e një infrastrukturë të nevojshme për personelin dhe efektivat në të gjithë vendvendosjen, në ndërtimin e pallateve për strehimin e familjarëve e shtëpinë e ushtarakeve e të tjera. Arritjet janë të dukshme, por dhe vështirësitë e mëdha e pengesa nga më të ndryshme. Pesha që mban komandanti është më e madhe në këto raste. Edhe Ndoja për këto si lider merr përgjegjësitë e veta e këtë kërkon edhe nga të tjerët, të cilat në libër paraqiten me imtësi. ... Duke ndjere përgjegjësinë si kuadër profesionist me ndërrimin e sistemit mbi

bazën e përvojës dhe të kërkesave të kohës, Ndoja do të shprehte mbështetjen për reformat në ushtri, por në letërkëmbimin me leadershipin ushtarak e politik do të bënte propozime e sugjerime, që mund të ndihmonin në këtë drejtim, siç dhe dëshmon dhe në libër. Në kuadrin e reformave të ristrukturimit të ushtrisë ju përgjigj me predispozicionin që e karakterizon në çdo detyrë, që u caktua deri në detyrën e shefit të shtabit të Divizionit dhe gradës së larte kolonel, që koincident me punën për ringritjen e Divizionit mbas ngjarjeve



të marsit 1997, që kane gjete trajtim të veçante në një kapitull.

Autori, me librin “Kujtimet e një ushtaraku” jo vetëm që ka rrëfyer për jetën e tij 45 vjeçare, por për ne ish ushtaraket, është dhe një kujtesë e gjejmë vetveten në shume pjese të librit pavarësisht se kemi qene ose jo bashkë, por gjate punës i kemi përjetuar, duhet marre dhe si një thirrje që behet se secili të hedhe në letër

atë eksperience që ka kaluar si pjesëtarë i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Libri me materialin e shumte që ka, mendoj se, është i dobishëm dhe për kuadrot e rinj ushtarake.

Lexuesi civil nëpërmjet këtyre kujtimeve do të njohë më mirë autorin dhe do të krijojë një përfytyrim më të plote të këtij profesioni të veçante, që nuk mund ta beje çdokush për veçoritë që ka, që nga uniforma, zgjedhja e vend banimit, vendit të punës, kohëzgjatje të orarit të punës, situatat e rreziqet që paraqiten gjate op-

eracioneve që shkon deri në denjën e jetës e të tjera.

Autori në libër, në përmbajtjen e tij plotëson devizën, që duhet të udhëheq një ushtarak: Nderi – Detyra – Atdheu – Familja”.

N/Kolonel **Dede Zhivani**, në rezervë, drejtor i Burgut në Shënkollë dhe bashkëpunetor i autorit, nder te tjera u ndal:

“Ajo është një ndërmarrje e guximshme, me një përkushtim e vullnet të jashtëzakonshëm e përmbushur me dije e kulture profesionale e letrare, historike e shkencore, e shtrire në hapësirë e në kohë, ku përfshihen disa breza, e përshkruar nga fillimi deri në fund, nga një fill i arte i vërtetësisë, realizmit dhe idealizmit të rrallë, ashtu siç është vete autori, në të gjithë punën e veprimtarinë në jetën e Tij. .... Në këtë botim personazhi kryesor, rreth të cilit vërtiten e përshkruhen të gjitha ngjarjet është vete autori, por aty Ai, Ndue Sanaj është vetëm në 50 %-in e jetës e aktivitetit të Tij. ... Aktivizimi e kontributi i Tij në jetën e shoqërinë civile është, po aq i madh, i lavdërueshëm dhe i nderuar, sa dhe ai ushtarak.

Ndue Sanaj bashkë me intelektual të spikatur dukagjinas krijuan Shoqatën Atdhetarë “DUKAGJINI” dhe Ai është në krye të saj, që nga themelimi e deri sot. Pa u zgjatur, unë, duke qene gjithnjë i pranishëm në veprimtaritë e tyre, siç edhe jam shprehur publikisht në media, i qëndroj në përfundimin tim se, organizimi e funksionimi i kësaj shoqate, jo vetëm është modeli më i mirë i simotrave, por nuk besoj, se ndonjë shoqate tjetër në historinë e shqiptareve të ketë pasur arritje e funksionim të tille, si ajo. Në gjykimin tim, ajo është “MREKULLIA DUKAGJINASE”, që në krye të saj, në udhëheqjen e drejtimin e saj ka qene dhe është intelektual e idealisti i palodhur dhe i pathyeshëm Ndue Sanaj. Besoj se, Ai ka filluar të shkruaj e plotësoj edhe 50 %-in tjetër të kujtimeve, për jetën e veprimtarinë e Tij dhe të shoqatës”.

Veprimtari **Aleks Dushi**, mësuesi në pension, nder të tjera u ndal: “Ai tregon duke përjetuar. Shpesh duket sikur sapa ndodh ngjarja. Kujtoj ngjarjen me Gjergj Dëllinjën, i cili i shkëputur nga libri është një tregim i mirëfilltë artistik.

Nëse i analizoni të dy llojet e kujtesës, ju mund të shihni se kujtesa episodike autobiografike ka të bëjë me kohën subjektive. Ju lejon të rijetoni përvojat e mëparshme, me fjalë të tjera, kjo ju lejon të ndiheni sikur po jetoni përsëri përvojat tuaja, një lloj udhëtimi mendor në kohë.

Autori jep shpjegime për ato ngjarje në të cilat mori pjesë. Ato marrin force kur përdorët një gjuhë më letrarizuar dhe stilizuar, atëherë nuk flet për autobiografi, por as për kujtime në mënyrë eksplicite, por i shkrin ato në veprën e tij. Një prozë e tillë autobiografike paraqet një panoramë të gjerë dhe intriguese të jetës. Ajo nuk prezanton thjesht jetën e shkrimtarit të saj;





një tekst i këtij lloji shpesh përball jetën e shkrimtarit dhe atë që rrëfen rrënimtari i saj. Këtë bisedë e kam bërë me autorin qysh kur kaloja nëpër duar faqet e këtij libri dhe mendoja secilën pjesë si tregim në vete.

Një pjesë e rëndësishme e këtij libri është dhe marrëdhënia me ushtarët dhe kolegët. Autori e shikon si një problem të rëndësishëm, por e konsideron: "Në përgjithësi bëja përpjekje, të kisha marrëdhënie korrekte me të gjithë personelin sipas niveleve të komandimit ushtarak. Megjithatë gjatë kryerjes së kësaj detyre pata disa probleme". Në bisedat me autorin e konsideroja problem të rëndësishëm dhe si aftësi psikologjike dhe formuese, gjë që autori tregon më shumë kujdes se për marrëdhënie sipas niveleve të komandimit, por gjithsesi mbetet në kornizën e komandimit ushtarak. Kujtoj marrëdhënien ndërmjet oficerit të emëruar rishitas, ushtarit dhe nën oficerit që kryente detyrën e komandantit të kompanisë".

Major **Gjon Bruçi**, në pension, në mes të tjerave u ndal: "Autori e ka titulluar librin e tij "Kujtime të një ushtaraku", por realisht libri në fjalë i tejkalon kujtimet e autorit si individ. Në këtë libër voluminoz, ndonëse autori flet në vetë të parë, janë paraqitur momente, episode dhe ngjarje nga jeta dhe veprimtaria e Ushtrisë sonë në dy kohë, para dhe pas viteve nëntëdhjetë, një periudhë kjo gjysmë shekullore. Personazhet e librit, ashtu si dhe episodet e ngjarjet janë të shumtë. Këta personazhe janë nga të gjitha shkallët e ushtrisë, por kryesisht ato i përbëjnë ushtarakët aktiv, të cilët edhe nëse nuk e shohin emrin e tyre midis këtyre personazheve, e ndjejnë veten pjesëtar të librit. Kjo ndodh falë paraqitjes me vërtetësi të atyre që kanë ndodhur, por edhe konkluzioneve e deduksioneve të drejta e të sakta të autorit për problemet që shtjellon. ... Libri "Kujtimet e një ushtaraku", ndonëse një libër voluminoz përmbi 600 faqesh, lexohet si i thonë "me një frymë". Kjo rezulton kështu, sepse libri është shkruar me profesionalizëm. Kolonel Ndue Sanaj, sigurisht nuk pretendon të jetë profesionist i shkallës së parë në fushën e krijimtarisë artistike, ku bën pjesë edhe zhanri i kujtimeve, por ai është profesionist në tre aspekte: Në profesionin e tij si ushtarak i karrierës; në përkushtimin për zbatimin dhe realizimin e detyrave të vështira të ushtarakut; dhe mbi të gjitha, ai është profesionist në dashurinë e madhe për vendlindjen e tij, për Atdheun, për gjithë Shqipërinë. Janë këto arsyt kryesore, që ai na ka dhënë një libër me vlera për të gjithë ushtarakët dhe për gjithë qytetarët e vendit, kudo që jetojnë e punojnë ata.

Libri "Kujtimet e një Ushtaraku" i Komandantit Ndue Sanaj, është një kontribut i çmuar edhe për historikun e Ushtrisë Shqiptare. Me njohuritë, faktet dhe argumentet që sjell në librin e tij, mua ushtarakun e thjeshtë, por edhe çdo qytetar të zakonshëm, na armatos me argumente për të përballuar çdo nihilist për çështjet e ushtrisë sonë, për të demaskuar të gjithë ata që sot në kushtet e reja të

vendit, predikojnë "padobinë" e një ushtarë si ajo që kishim para viteve nëntëdhjetë, e madje edhe duke ironizuar e nënvleftësuar djersën dhe mundin që derdhën ushtarakët tanë në forcimin e Ushtrisë dhe të mbrojtjes së vendit".

Konsulli i Nderit të Austrisë në Shkodër dhe N/kryetari i SHAD, z. **Gjergj Leqeja**, i cili nder të tjera u ndal: "Tuj lexue me vëmendje librin me kujtime të Kolonel Ndue Sanaj, megjithëse ai me modesti



shkruan se nuk kam kenë nuanës i mirë në letërsi, krahas kujtimeve të bukura e të "hidhura" sidomos për brezin e Ndues e deri te brezi jone mund të kuptosh edhe gjendjen e metamorfozën e Ushtrisë Shqiptare që nga momentet e mbasluftës, fillimin e shkatërrimit me heqjen e Gradave në vitin 1966?, në shkatërrimin total me politizimin e tejskajshëm me futjen e Komisarëve politike e deri në vitet 90-të, me ndryshimet demokratike të vendit e ma tej.

Por, në të njëjtën kohë, në kujtimet e Kolonelit, që unë jam plotësisht dakord, vëren se pavarësisht politizimit të tejskajshëm, kultivimit të karrierizmit pa vlera, servilizmit e paaftësisë në sistem, në Ushtrinë Shqiptare kishte e ka individë, për mendimin tim shumica, të përkushtuem në detyrë, patriotë të vërtetë, ushtarë e komandante të afte dhe të përgjegjshëm për të sakrificue çdo gjë për mbrojtjen e vlerave, kufijve e jetës së qytetareve të Republikës së Shqipërisë.



Në kte libër janë përshkue shumë ngjarje e persona konkrete, tuj fillue nga Shkolla ushtarake e në gjithë vendet ku ka shërbye nga Kruja në Kukës e Kelmend, që përfaqësojnë vlerat e vërteta të ushtarakut e një nder to mjaft përfaqësues e them me bindje se asht Kolonel Ndue Sanaj, të cilit i baj komplimente për çka ka shkruar në kte libër e demonstrue në jete".

Zonja **Linda Kavaja**, gazetare pranë TV1- Channel, në mes të tjerave u ndal:

atë shprehjen e dikurshme "a doni më për Belulin", sepse me njohjen që kam unë me të, dhe besoj se nuk është pak, me korrektesinë që e karakterizon, ato që shkruan aty shpalosin vërtetësi të bindshme.

Libri është i rrjedhshëm, nuk të mërzitë me përsëritje, me kopjime pjesë-pjesë nga të tjerët. Këtu është ushtria shqiptare nga vitet gjashtëdhjetë e deri në shkërmqojen e viteve nëntëdhjetë dhe ringritjen e saj, të para dhe të vlerësuar nga një ushtarak i lart si Kolonel Ndue Sanaj. Ky libër është shkruar dhe pasqyruar me gjakftohtësi.

Unë po e mbyllë këtë përshëndetje për mikun tim Ndue Sanaj, dhe librin e tij "Kujtime të një ushtaraku", duke shprehur një dëshirë, që besoj se nuk është vetëm personale imja por edhe plotësim dëshire i shumë shokëve dhe miqve të zotit Sanaj, gjithashtu edhe jona, e opinionit të përgjithshëm ushtarak dhe civil. Këtë e shpreh edhe si pjesëtar i redaksisë së gazetës Dukagjini. Do të ishte mirë, mendoj, që ndonjë ushtarak që ka njohuri sa më të plota për jetën ushtarake, ushtrinë, dhe përvojë në shërbimin ushtarak, të mund ta gicillojë pak zotin Ndue me disa pyetje, në formë bashkëbisedimi-tani pas botimit, se çfarë ka thënë, a i ka thënë ato që duheshin thënë, apo çfarë i ka mbetur pa thënë, si ndjehet pas botimit, si ka reaguar opinionit, shokët dhe miqtë e tij, e të tjera, për ta botuar në ndonjë gazetë, por Unë dëshiroj në gazetën "Dukagjini".

\*\*\*

Nga miqtë tonë dhe të autorit të librit, Ndue Sanaj, në pamundësi të marrjes pjesë për efekt të pandemisë, kane dërguar opinionet e tyre, në mes tyre Shkrimtari, poeti e veprimtari Prend Buzhala, nga Klina, të cilin e lexoi poeti Lulash Brigja.

\***Shkrimtar Prend Buzhala**, në mes të tjerave ndalet: "Duke i vënë vetes për qëllim që ta shquajë dashurinë e përkushtimin e pakufishëm ndaj Atdheut për një jetë të tërë, libri "Kujtimet e një ushtaraku, 45 vite jetë ushtarake" vjen me një pasuri të madhe dokumentimi, rrëfimi e shtjellimi, qofshin ato momente gëzimi a pikëllimi, triumfi a përshkrime ngjarjesh ku përplasen pushteti i ideologjisë totalitare me logjikën e përpiktë e të ftohtë të atdhetarit (kujto shënimet për 21 të dënuar në Has). Po qe se në tekstin e prologut e nis me thënien e njohur "Arti shtetit e përfshin artin e luftës", libri përshkohet edhe nga një dimension tjetër, përpos atij dokumentar, reflektues apo memorizues. Shkrimtari i shquar V. S. Naipul do të thoshte: "Të gjitha detajet e jetës, çuditjet dhe miqësitë mund të përcaktohen për ne, por misteri i shkrimit do të mbetet. Asnjë sasi dokumentacioni, sado tërheqëse të jetë, nuk mund të na çojë atje."

E pra, ky kod zbërthyes i këtij dokumentimi të gërshetuar me kujtesën, dëshminë, personazhet konkretë, përshkrimet e situatave, fotografinë etj., e ka edhe misterin e vet, do të thoshim, e ka magjinë apo prirjen e jashtëzakonshme që e kanë personalitetet e rralla njerëzore: të duash atdheun, do të thotë t'i duash njerëzit e tij, vlerat e tij historike, ato të traditës, apo



ato të mendësisë etnike; do të thotë të kesh forcën tërheqëse të ndikimit, shpesh të pashpjegueshëm, të komunikimit njerëzor; do të thotë, të kesh prirjen për veprim dhe rezultate dhe, gjithsesi, edhe ndërtimin e një autoriteti të ligjshëm përreth vetes e vendit ku jeton e vepron. Të gjitha këto cilësi dalin natyrshëm, kur t'i biesh veprës në fund. Mbi të gjitha, është qëndrimi e këmbëngulës i njeriut të Drejtë dhe kërkimi i drejtësisë në mbrojtje të dinjitetit njerëzor e ushtarake: këtë e kërkonte edhe në kohën e regjimit komunist (janë të shumtë detajet e përjetimeve të ballafaqimeve), këtë e kërkonte edhe në kohën e rendit demokratik përballë një ministri ("e kishim shtetin ligjor, por nuk kemi pasur shtet të së drejtës, dhe këtë e kërkojmë se kjo është në themel të demokracisë").

Në vepër parakalojnë emra ushtarakësh, eprorësh, politikaneësh, ministrash, autoritetesh të larta shtetërore e deri te emrat e njerëzve të thjeshtë. Kontakti, bashkëbisedimi, ballafaqimi a përjetimi me secilin prej tyre, qoftë edhe vetëm si prani, bart një të vërtetë të kohës, një të vërtetë personale dhe një dëshmi mesazhi a domethënieje kuptimplote?

Po, dhe aktori, shkrimtari e veprimtari i palodhur, zoti Ismet Krasniqi-Lala, nga Klina, ka dërguar opinionin e tij, të cilin e lexoi mësuësi në pension, Prele Shtyani.

\***Aktor Ismeti Krasniqi**, në mes të tjerave ndalet: "Gjatë leximit të librit" KUJTIMET E NJË USHTARAKU", lexuesi mund ta shohë si një skenar filmi të metrazhit të gjatë, ajo që paraqitet në libër i përgjigjet secilës kohë me ngjarjet e saj për 45 vite të plota, por skenari i filmit nuk e duron një përshkrim të tillë për shkak se në film duhet tejkaluar e shpejtuar kohët e duke i gërshetuar ngjarjet me një përshpejtim për të përfunduar ngjarjet në kohën në sekuencat e kohës filmike. Me një fjalë, Ndue Sanaj e ka daltuar artin ushtarak në fjalën e bukur të shkruarit të një personaliteti ushtarak. Kjo mund të shumëzohet edhe në shumë personalitete ushtarake të kohës së tij. Në libër përshkruhen ngjarjet origjinale të kohës. Kjo e bën lexuesin më tërheqës për librin. Krijohet bindja se ushtaraku, siç ka qenë i vendosur në marrjen dhe dhënien e komandës ushtarake, po ashtu ka qenë i përpiktë edhe në shkrimet e tij.

Në libër na del në pah një ushtarak që ka vepruar në organizatën bazë të partisë, si gjithë ushtarakët e kohës, por ushtaraku Ndue Sanaj dallon nga të tjerët. Ka qenë i vendosur në komandë, por ka pasur edhe një aftësi të veçantë për ta relaksuar situatën në momente tensionimi e kjo ka ndikuar në rritjen moralopolitike në meset e caktuara. Në libër me pak kujdes e vëren aftësinë e ushtarakut për komunikim masiv, gjë që nuk haset kjo te të gjithë ushtarakët. Kjo vërehet në kohën e fillimit të proceseve demokratike, siç janë zgjedhjet e reja e ngjarjet e vitit 1997. Ndue Sanajn në këto procese e gjejmë gjithmonë vertikalisht, të pathyeshëm e të qëndrueshëm drejt proceseve të reja demokratike".

\***Major Mynyre Gojashi**, ne pa mundësi të marrjes pjese, ka dërguar opinionin e tij, që ne mes të tjerave është ndalur: "Nisma juaj për të shkruar kujtimet, kur teknologjia na e mundëson më shumë duhet të nxisë edhe të tjerë për të shkruar e pasuruar këtë fond. Përmes rrugëtimit tuaj ju i keni bere një skaner reformave e zhvillimeve në ushtri sipas përvojës tuaj të çmuar. Ky është një kontribut me vlere si nga ana ushtarake, por e kombinuar me ngjarjet e situatat socialpolitike që ka kaluar vendi ynë. Në libër për problemet ushtarake behej një analize e sakte



teorike e praktike ku jepej edhe eksperiencia e përvoja juaj për rrugët që duhen ndjekur për eliminimin e mangësive dhe përmirësimin e punës. Me shumë interes lexova pjesët ku flitej për punën e bere dhe

metodën e ndjekur për stërvitjen e vogël, marrja e mendimit ndarja e detyrave, kërkesa e llogarisë dhe sidomos praktika e kontrollit për zbatimin e detyrave në baze të normave të përgatitjes luftarake. I theksoj këto elemente sepse janë baza e formimit të kuadrit ushtarak".

**Profesor dr. Vuksan Kola**, në pamundësi të marrjes pjese, dërgon mesazhin përshëndetës, që në mes të tjerave theksonte: "Ushtria ka qenë sektor i mblyllur për publikun, por kur lexon librin kupton se sa mund e djersë është derdhur

kuptohet se keni kaluar një jetë "në luftë" për të qenë gati për një luftë të mundshme. Një jetë me tension të madhe fizik dhe psikologjik, por të përballuar me dinjitet, pa e shkarravitur personalitetin tënd në asnjë rrethanë dhe përpara askujt, tamam në traditat më të mira të një dukagjinasi të vërtetë".

Kolonel **Eqrem Osmani**, në pension, në mes të tjerave thekson: "I dashur Ndue! Ndoshta njihemi pak nga afër, por libri është me vlere të larta jo vetëm letrare e artistike, por dhe ushtarake, historike, filozofike, më imponon shumë respekt dhe më duket sikur kemi qene shumë pranë njeri-tjetrit si skënderbegas, shokë pune dhe ideali kudo në jetë..... Këtë ma imponon origjinaliteti i të shkruarit dhe aq më tepër ndershmëria, drejtësia, kuraja dhe guximi burrërore që e përshkruan çdo ngjarje e ndodhi të jetës tuaj me plot suksese, por dhe me jo pak vështirësi që kini ditur ti përballoni me sukses e mençuri si rralla kush tjetër".

Historiana **Rita Shkurtaç**, në mes të tjerave thekson: "Një penë e hollë e lakuar me një mjeshtëri të madhe nga një mendje po aq e hollë e autorit ka mundur ti kthejë këto kujtime në burime deri edhe shkencore për studiuesit

në çdo pjesë të vendit, për të siguruar në çdo rrethanë mbrojtjen e atdheut. Dhe ushtria, në përgjithësi, nuk e shkeli betimin ushtarak në ato ditë të vështira të vitit të mbrapshtë 1997. Nga kujtimet e tua

dhe hulumtuesit të cilët fare mirë mund ta shfrytëzojnë si një material burimor, të mbështetur dhe faktuar edhe mbi dokumente zyrtare sidomos për ata që studiojnë sot në Akademinë Ushtarake. Edhe pse kujtimet e tij lidhen kryesisht me karrierën ushtarake nuk mund t'i anashkaloj, madje do veçoj kujtimet dhe vlerësimin që z. Sanaj përshkruan për Banorët e Krahinës së Kelmendit, duke i veshur ata me bujari e fisnikëri aq sa të krenohesh me ta si malësor të denjë që ditën ta dëftojnë veten edhe në ato kohë të vështira. Ndër të cilët përmendet edhe plaku i urte i Kelmendit Ndue Dragu. Kujtime që ja vlen të dëshmojnë, pasi me të vërtetë të ngjallin nostalgji pse jo dhe krenari për kohën që u jetuan tek ngjiste shkallët e karrierës së tij si një nga shumë e shumë ushtarakë që bënë epokë me ambiciet e tyre për të bërë diferencën në shoqërinë e realizmit socialist. KUJTIMET E NJË USHTARAKU padyshim që janë pasuri më vete për brezat e ardhshëm, pasi nëpërmjet këtij libri ata kanë për ta kuptuar se si funksiononte një pushtet i centralizuar. Aty do njihen me mënyrën e organizimit social, madje edhe me rolin që luante përgatitja ushtarake e të gjithë shoqërisë së asaj kohe së cilës i bindeshin të gjithë pa asnjë kundërshtim".



Poetja **Bona Mulaj Lluka**, në mes të tjerave thekson: "Kujtimet e një ushtaraku" libri që jo vetëm për nga faqet që mban, por dhe nga rëndësia që mban çdo faqe e shkruar në te, peshon goxha rende, na mblodhi në Bibliotekën e Universitetit "Luigj Gurakuqi" Shkodër, miq, kolege, familjare, personalitete e gazetar. Megjithëse një libër me mbi 600 faqe, e kam lexuar me endje, sepse në kujtimet e Kolonel Ndue Sanaj, koha më ktheu pas dhe shumë histori të treguara nga halla



ime, oficerja e pare e rrethit të Pukës, Dila Mulaj (aq sa u lejohej të tregonin asokohe për punën e tyre). Një salle e mbushur me personalitete e qenë çdo kumtese mu përcoll fisnikëria e disiplina ushtarake e zotërinjve dhe zonjave të nderuara, përtej të qenit aq të përgatitur e të formuar. Desha disa here fjalët e mia si mbesa e një ushtarakje ti përcillja në atë foltore, por ushtaraket nuk i duan lotët mendoj e unë nuk i shmangia dot emocionet që mund të krijonte rrëfimi im. Urime e suksese pafund Kolonel e paç shëndet e vullnet për të shkruar gjithë jetën. Respekt për ju e familjen tuaj”.

Kolonel Hysen Qendro ne pension, në mes të tjerave thekson: “Kolonel Sanaj, është një nga ushtaraket e rangut të larte, që ka punuar dhe drejtuar në njësit e mëdha të ushtrisë, në sistemin e kaluar dhe disa vite në ushtrinë e sistemit të sotëm demokratik.

Ky djalë nga Malësia e Dukagjinit, në moshën katërmëdhjetë vjeçare, erdhi në shkollën e mesme ushtarake “Skënderbej”. Që në ato vite e deri sot, që ka dale në pension, qëndroi i vendosur dhe me dinjitet dyzet e pese vjet në shërbim të vendit.

Ai ka ngjitur shkallet e hierarkisë ushtarake, që nga nivelet e ulëta e deri në Brigadë e Divizione të ushtrisë tone.

Në këtë libër ai ka pasqyruar shume veprimtari që kryheshin nga ushtria jone në atë kohe, në përputhje me parimet dhe kërkesat e Artit tonë Ushtarak dhe detyrave të mbrojtjes.

Ndueja ka dhanë një kontribut të madh për rritjen e nivelit teorik e metodik të kuadrove, komandave dhe shtabeve, në njësitë ku ka punuar dhe drejtuar. Në këtë libër ai përcjell te lexuesi përkushtimin, vendosmërinë dhe sakrificat që kane bere ushtaraket Shqiptare, për të zbatuar detyrat e mëdha të mbrojtjes së vendit në atë kohe”.

Kolonel Gjovalin Shyti, në mes të tjerave thekson: “NJË KRONOLOGJI BRILANTE, TË NJË JETE TË GJATE ME UNIFORMË USHTARAKE. Është impresionante që jeni tregua shumë mjeshtër në kapërcimin e të gjithë atyre pengesave, që të kanë dale në jete. Besoj, se edhe ndihma e shokëve, miqve, kolegeve të ka ndihmuar për të ecur (edhe kjo është mjeshtëri). Shëndet e jete të gjate pranë familjes! Përqafime!”

\*\*\*

Në promovimin e librit për shëndeti profesor dr. Mark Palnikaj, koloneli në rezerve Zef Lleshi, kryetari i Shoqatës Atdhetare “Malësia e Madhe” Ilmi Kurti, kolonel Skënder Yzeiri dhe studiuesi, botuesi e publicisti Prele Milani.

Në mbyllje të kësaj veprimtarie, foli dhe autori i librit, kolonel Ndue Sanaj, në pension, i cili nder të tjera tha: ‘Shkrimtari Lazer Stani, shkruan: “Ato ngjarje, që nuk kanë mbetur në memorien tonë, nuk janë më kujtime”. Prandaj kam bërë përpjekje, që të sjell të vërteten ashtu siç janë zhvil-



luar ngjarjet, siç kanë mbetur të pashlyera në memorien time. E di se në këto ngjarje ndonjëri personazh dhe nuk i ka ardhur mirë, por asgjë nuk ka qene qellim keq. Por dhe disa gjera duhen thënë, se në çdo periudhë ka qene dhe është hipokrizia, mendësia të shfrytëzoj sa ta kemi në dorë, se nesër nuk i dihet ... Ka qene dhe vijon të jete subjektivizmi në vlerësimin e njerëzve, në përkrahjen e njerëzve në punë. Prandaj askush nuk duhet të preket ...”

Ka pasur dhe prononcime nga miq e koleg të

Kolonelit, që mundem të veçojmë:

\* **Ndue Marku:** “Një promovim libri model, me një pjesëmarrje intelektual të shquar, me referenca tërheqëse e mbyllur me një dreke dinjitoze tek Bar-Restorant “San Francisco”, Shkodër, që ishte “qershia” mbi tortën e datëlindjes të autorit NDUE SANAJ. Në te dy ceremonitë pjesëmarrësit shprehën vlerësimet për kolonelin në pension dhe në të njëjtën kohë për Kryetarin e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” z. NDUE SANAJ.”

\* **Zef Nika:** “Suksese Ndue Sanaj. Libri është n j e

dëshmi rrëqethëse e bazuar në fakte. Janë dëshmi të bazuar në fakte, të cilat të bëjnë të mendosh se me sa vesh tersi u përballuan ushtaraket tanë. Një jete tjetër nga jeta civile. Libri është i kuptueshëm për të gjithë dhe një mësim i madhe për armatën e re të ushtarakëve. Të uroj shëndet të plote!”

\* **Kujtim Çako:** “Promovimi i një libri është një dritare informimi dhe dije më shumë. Urime autorit dhe njëherësh kryetar i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” Kolonel (P) Ndue Sanaj”.

\* **Kolë Krasniqi:** “Urimet më të mira. Shumë suksese në vijimësi. Përsëritet të përzemërta!”

\* **Imer Hysa:** “Urime! Libra të tilla që mbajnë gjalle në kujtesë jetën dhe veprën e njerëzve, veçanërisht të atyre që sakrifkuan gjithçka në mbrojtjen e Atdheut, që vëllezër kishin koleget dhe jetën e kaluan larg familjeve prindërore. Autorit i uroj jete të gjate e suksese në libra të tjerë”.

\* **Leke Imeraj:** “Ndue Sanaj dhe shumë të tjerë si ai kanë shumë për të treguar dhe trashëguar. Duhet të shkruajmë dhe flasin. Respekt dhe suksese!”

\* **Kadri Ujkaj:** “Ndue Sanaj, publicist dhe memorialist i këndshëm, shok e mik i nderuar, që i nderon dhe i mishëron vlerat si autor bashkëkohor”.

\* **Hys Hasa:** “Përsëritet dhe urime kolonel Ndues e Zoti i dhashte jete e shëndet që të na shkruaj, të botoj e të na gëzoj me libra të tjerë. Shumë respekti për kolonel Nduen, por edhe për ju z. Dede, që me shumë dashamirësi e keni shkrua e vlerësua punën e madhe të kolegut. Ju përqafoj me shumë mall, respekt e mirënjohje!”

\* **Tahir Bezhani:** “Urime miku im, Ndue Sanaj! Paç shëndet të mirë e jete të gjate, suksese në krijimtari të mëtejme e shumë të mira tjera në jetë!”

\* **Idriz Berisha Xhixhi:** “Edhe pse kishim ftesë nga organizatori i promovimit e autori i librit voluminoz Z. Ndue Sanaj, e patëm të pamundur një grup nga Klina pjesëmarrjen në atë veprimtari festive, për shkak të Pandemisë dhe masave ndaj sajë. Përzemërsisht urime dhe suksese në vepra të tjerë i dashur Ndue Sanaj! Shëndet e mbarësi!”

\*\*\*

Kjo veprimtari u mbyll me një fotografi e përbashkët me të gjithë pjesëmarrësit.

Pas kësaj veprimtarie, me kolege, miq e familjar, Ndue Sanaj, shtroj një dreke te Bar-Restorant “Sanfrancisko”, me rastin e 78 vjetorit të lindjes së tij, që në emër të redaksisë së gazetës “Dukagjini”, i uroj të plotësosh 100 vite!

**Përgatiti Luigj Shyti,**  
Shkodër, me 5 shtator 2021





# TË FLASËSH DHE TË SHKRUASH TË VËRTETËN ËSHTË ARTI MË I RENDË NGA TË GJITHA ARTET!

- fjala në mbyllje të promovimit të librit -

Ju përsëritës të gjithëve dhe ju them: Faleminderit që rezervuat pak kohë nga koha e juaj shumë e çmuar dhe u bëtë pjese e imja!

Ju falënderoj dhe ndjem shumë i nderuar për konsideratat që shprehën folësit, koleget e miqtë e mi, ndaj punës sime, ndaj punës sonë të përbashkët në shërbim të Atdheut; familjes sime dhe në veçanti për punën time me librin!

Një personalitet thoshte: "Shkruaj..., po nuk pate letër, shkruaj në gurë!" Prandaj, duke u bazuar në këtë shprehje, bëra përpjekje të shkruaj, që jetën e 45 viteve ushtarake të mos ja la "na ishte njëherë", por ta la të shkruar. Në këtë libër ka gjera shumë serioze, por ka dhe gjera, që brezave të ardhshëm do ju duket e pabesueshme. Por kjo është jeta, kjo është e bukura e saj, që asgjë nuk shkonte dhe nuk do të shkoje në vaj.

Këtu doli dhe ndonjë problem, dhe ata që i ngritën, tregon se janë të përgjegjshëm për çka thonë, kanë lexuar librin dhe problemi ju ka tërhequr vëmendjen. Ai nuk është si njeri, koleg i joni, që në mes të tjerave më shkruante: "Të betohem, nuk e kam hapur fare librin tand, sepse më kanë thënë shkurt ato që ke shkruar për një ngjarje ..., që nuk duhej ta kishe cilësuar!"

Unë i them të lumtë dhe të lumtë, se kështu e keni ndërtuar jetën tuaj, Libri nuk është thashetheme, pavarësisht nëse të pëlqen apo nuk të pëlqen, është tjetër gjë, se është normale të keni mendime ndryshe, në veçanti kur ato shkruhen.

Një person i thotë një botuesi, se ju nuk kishe shkruar asgjë, që të më pëlqente... Autori i thotë:

-Ma jep dorën dhe ai ja dha dorën. Po sa i dha dorën, autori i tha:

-Të falënderoj që ma paske lexuar librin! Kritikuesi mbeti ...

Kështu dhe ka, por nuk mund të ketë nga një i shkolluar e me detyra të larta, si ai që më shkruan mua ...

Personi që më shkroi, se nuk ta kam lexuar librin, i kam dhuruar pese libra dhe për asnjërin nuk më ka thënë gjë, se për të shkruar ndonjë rresht, as nuk bëhet fjalë. Kështu, nuk prisja ndonjë gjë të veçante prej tij as në këtë rast, por ketë që më shkroi nuk e prisja. Ndoshta donte të më mërziste mua, por dhe këtu gaboi... I them dhe njëherë: Të lumtë!

Gorki i madhe gati një shekulli më parë shkruante: "Të flasësh dhe të shkruash të vërtetën është arti më i rendë nga të gjitha artet" Pra, gjithësi mos njeri, tjetri do ta shkruaj të vërtetën ...

Shkrimtari Lazer Stani, shkruan: "Ato ngjarje, që nuk kanë mbetur në memorien tonë, nuk janë më kujtime". Prandaj kam bërë përpjekje, që të sjell të vërtetën ashtu

siç janë zhvilluar ngjarjet, siç kanë mbetur të pashlyera në memorien time. E di se në këto ngjarje ndonjëri personazh dhe nuk i ka ardhur mirë, por asgjë nuk ka qene qellim keq. Por dhe disa gjera duhen thënë, se në çdo periudhë ka qene dhe është hipokrizia, mendësia të shfrytëzoj sa ta kemi në dorë, se nesër nuk i dihet

Rinisë (student) Shkollore, koleg e vartës, eprore e superior, kane punuar pa bërë fjalë, shumë prej tyre kane punuar shumë, duke mos folur, janë orvatur të kryejnë detyrën, se shembulli personal është vlere frymëzimi, është vlere idealizmi. Ketë frymë kam bërë përpjekje ta paraqes, që nga fillimi e deri në fund të librit.



... Ka qene dhe vijon të jete subjektivizmi në vlerësimin e njerëzve, në përkrahjen e njerëzve në punë. Prandaj askush nuk duhet të preket ...

Një shprehje të Imzot Gibier nuk e kemi njohur, nuk kemi njohur as Imzotin Gibier, por jo pak efektiv i ushtrisë shqiptare, që nga ushtari aktiv apo rezervist, nënoficer aktiv apo rezervist, oficer aktiv apo rezervist, efektiv i Forcave Vullnetare e të

tyre viteve i kam borxh kujt, së pari i kam borxh Atdheut tim, së dyti i kam familjes sime dhe të dyve ju kërkoj falje ...

Ju faleminderit ju pjesëmarrës, por më lejoni të veçojë zotin Ndue Mici, të cilit dje i ka vdekur vëllai në Nju-Jork, dhe gjeti forcën të vije e të më respektoi mua dhe juve, i cili nesër pret vizita ngushëluese në shtëpi. Ngushëllime Ndue Mici!

I faleminderit kolonel Flamur Muçes, Poetit Lezer Kodrës. Profesor Gjergj Perluces, N/kolonel Dede Zhivanit e N/ Kolonel Ndoc Selimit (fatkeqësisht nuk jeton më), të cilët me përgjegjësinë e tyre qytetare, me sugjerimet tyre, madje nga njëherë dhe me debate pafund, më ndihmuan të shkruaj këtë libër. Mirënjohje për juve!

I faleminderit të gjithë atyre, që më ndihmuan të botoj këtë libër: Në mënyrë të veçantë zotin Sami Shoshi (sipërmarrës), që më ka mbuluar gati 50 % shpenzimet e botimit të librit; vajzat (Enkelejden, Edmiren e Enveiden), kapiten Gëzim Ejlli, Prele Çardaku, N/kolonel Gjergj Vocaj, Major Pal Vuksani, kapiten Prek Gjonaj, Angelina Gjoka, N/kolonel Gjovalin Shyti, Prelë Kroj, Hilmi Sakti, Alvar Dreni, File Moshqeti, Tringa Rapi e Ndue Mici. Mirënjohje e veçantë!

Falënderoj shtëpinë botuese 'FIORENTINA', me president shkrimtarin e përkthyesin Meritan Spahia, për punën e kujdesshme në botimin e librit. Mirënjohje!

Falënderoj personelin e bibliotekës "Luigj Gurakuqi", më në krye drejtoreshën, zonjën Valbona Berdica, për kushtet normale, që na siguruan për zhvillimin e kësaj veprimtarie promovuese. Mirënjohje!

Nënë Tereza, thoshte: "Pas çdo arritjeje vjen nisja, pas çdo rezultati, një sfidë e re!" Po, dhe unë pas këtij promovimi e suksesi, pas pese botimeve, kam nisur edhe projekte të tjera, prej të cilave tre i kam filluar, dhe besoj se koha ka me më dhanë mundësinë, që ato të shohin dritën e diellit në kohën e duhur.

Pra, nisje të tjera kanë filluar, të cilat janë një sfidë e re, në veçanti për nga ideja e mosha ime.

Më pëlqen ta mbyll fjalën time, me një citim, në mbyllje të librit: "Miq, koleg, familjare, më pëlqen ta mbyll gjithë këtë punë dhe me një thënie, pavarësisht, se kur të dali libri nga botimi "lapsi nuk do të ketë gomë", por goma e vërtete do të jetë opinion i lexuesve: "Askush nuk është i përsosur..., kjo është arsyeja pse lapsi ka edhe gomë".

Ju faleminderit!

**Ndue Sanaj,**  
Shkodër, 5 shkurt 2021



# MË MIRË VONË SE KURRË

Më në fund pas 85 vitesh u pa asfalti në qendër të fshatit Theth. Një pritje e gjatë, por më mirë vonë se kurrë!!! Duket se ju erdhi fundi udhëtimeve të stërmunduara për banorët e Thethit e të gjithë Dukagjinit. Por edhe për mijëra e mijëra turist vendas e të huaj, të cilët vizitojnë këtë perlë të mahnitshme. Jo me kot Thethin e vizitonin shumë turist edhe kur nuk ishte ndërtuar rruga automobilistike.

Rruga e Thethit është hapur në vitin 1936. Ndërtuar nga krahët e fuqishëm të Dukagjinasve me mjete primitive të asaj kohe e pa pagesë, shteti i kohës bënte vetëm furnizimin me lëndë plasëse. Pra, një sakrifice shumë e madhe. Këtë radhe mund ta bënte, përveçse dukagjinasve, të cilët ishin të etur për zhvillim e prosperitet. Nuk i trembeshin as shkëmbinjve të radhe të T' thoresë. Pozitive është se cilido mund të udhëtojë për në parkun turistik, i dyti për nga madhësia në vendin tone, pas atij të Dajtit. Kushdo të kalojë në këtë rrugë, duhet t'i japë një falënderim të madh shtetit që bëri asfaltimin e kësaj udhe. Ndonjëri mund të thotë se është bërë me taksat tona. Po ne taksa kemi paguar gjithmonë! Po rruga kishte mbetur ajo e 85 viteve më pare. Tani ju shtua edhe një arterie Alpeve, pas Valbonës dhe Vermoshit. Mendohet që një arterie tjetër të lidhë Thethin me Valbonën. Kjo i mbetet kohës. Nuk po ndalem më për Thethin, sepse tani është bërë i njohur, pa e ekzagjeruar në të gjithë botën. Por ky është një qoshe, se Dukagjini është shumë i madh, me vlera të pa zbuluara ose me thënë të virgjëra. Po Dukagjini ka vlera akoma më të mëdha. Është djepi i besës e i burrërisë, ndërsa për trimëri e ka treguar veten se nuk e ka pushtuar as krajl as mbret. Për pesë shekuj nuk ju nënshtrua turkut, madje i dogji sarajet. Po Dukagjini është dhe i artit, kulturës, muzikës e sportit. Janë me dhjetëra e dhjetëra të tillë. Po t' i përmendim vlerat e Dukagjinit e dukagjinasve nuk do t' i vinte kurrë fundi shkëmbinjve të kurrës. Më bëri shumë përshtypje një këngëtare e njohur për repertorin e saj, e cila në një emision të një televizionit, duke treguar vuajtjet që ka kaluar pas festivalit të 11-të, tha: "Me caktuan me ju mësuar

muzikë Dukagjinasve!!!" Një ironi e rendë, se Dukagjini ka pasur dhe ka muzikantë e këngëtar të shkëlqyer. Mund t' i them zonjës në fjalë, se falë Dukagjinit e dukagjinasve, se sot e kësaj dite Shkodra do të fliste turqisht. Por Dukagjini meriton shumë më shumë se asfaltimi i rrugës së Thethit,

do bënte që edhe fshatrat e tjera të marrin një zhvillim, i cili sot për sot mungon. Kjo zone është shumë atraktive për të gjitha llojet e turizmit. Siç janë, turizmi malor, historik, sportive, kulturor e të tjera.

Janë disa qafa me një histori të radhe, ku janë zhvilluar luftime të ashpëri



kjo për arsye se, është një zone piktoreske. Janë gërshetuara bukuritë e radha të natyrës me njerëzit e kësaj treve. Ndonëse kanë jetuar në varfëri, kanë jetuar gjithmonë kryelarte e me ndershmëri. Zhvillimi i infrastrukturës

për mbrojtjen e vendit.

Janë disa shpella, të cilat ngjallin interes studimi, që mundë të cilësojmë: Shpellat e Arapit, e Rrathëve, e Bravnikut, Kakverrit e të tjera.

Kanionet e lumit të Shalës, duke fil-

luar nga burimi deri në grykë derdhjen e tij, në liqenin e Komanit. Kanionit e të cilit janë aty, jo më pak me vlera piktoreske se të lumit Vjosa.

Turizmi kulturor zhvillimi i arsimit dhe vendet e shenjta, të cilat nuk mungojnë.

Zhvillimi i bujqësisë, blegtorisë, pemëtarisë, bletarisë e të tjera.

Po që të arrihen këto, kërkohet infrastruktura rrugore, sidomos zgjerimi dhe asfaltimi i rrugës nga Prekali deri në Theth afërsisht 40 km. Premtim ky i bërë në fushatat elektorale, sidomos 10 vjeçarit e fundit. Po ne shpresojmë se në mandatin e tretë të qeverisë Rama të realizohet ky investim jetik për këtë zonë. Do Zoti e të mos ketë fatin e rrugës Thethit. U desh afërsisht një shekull që të përfundonte!

Problem i pa zgjidhur për Dukagjinit edhe për zonat e tjera malore, është çështja e pronësisë mbi tokën dhe banesat e ndërtuara para viteve 1990. Ndonëse doli një vendim për këto problem Nr 20/2020. U bënë të gjithë dokumentacionet e kërkua për banesat dhe tokat bujqësore. Mbase një nga premtimet nga i cili mori shumë vota PS ka qenë edhe ky vendim. Por u bë një vit ku dokumentet e dorëzuara flenë në sirtarët e kadastrave!!! Mbase edhe qeveria dhe zoti Artan Lame do të kujtohen. Pasi mungesa e Certifikatave të pronësisë është një pengesë për investimet në këto zona.

Në Theth janë investuar rreth 6 000 000 Euro, për ndërtimet e infrastrukturën turistike. Të gjitha këto shpenzime, ndonëse janë bërë në pronat e tyre sipas kufijve të vjetër, ligjërisht nuk njihen!!!. Nuk mund t' i shesin as t' i blejnë, as nuk mund të bëjnë sigurimin e pronave në kompanitë e sigurimit, për rreziqet nga tërmetet, zjarret, përmbytjet e të tjera. Janë shitur e blerë shumë prona në Theth, vetëm me letra dore (bakalli) pa certifikatë pronësie, mbase nuk ndodh, por rreziku i konflikteve është prezent. Prandaj mendojë se, duhet parapri me dhënien e certifikatave të pronësisë.

Ka edhe problem, të cilat komuniteti duhet ti zgjidh vet. Pastrimi i kanaleve ujitës, ku çdo gjë është tharë nga temperaturat e larta. Në pamjen e pare të duket se je në fushën e Postopojës. Kur fshati i Thethit ka rreth 70 burime uji. Mendja të shkon, kur janë bërë të gjitha këto investime. Pse të mos bashkohen të riparojnë e pastrojnë këto kanale. Kjo jo vetëm do të rrisin prodhimet bio, bujqësore, por do i jepnin gjelbërim tokave bujqësore, livadheve dhe gjithë territorit të kësaj zonë. Pra, nga shteti kërkohen në mënyrë emergjente: Zgjerimi e asfaltimi i rrugësi nga Prekali në Theth; regjistrimi i pronave sipas kufijve të vjetër; shpërndarja e certifikatave të pronësisë sipas kufijve të vjetër.

Përgatiti Ndue Ziçi





# U NDA NGA JETA Mhill ÇUN GJONAJ, KRYERAPSODI I DUKAGJINIT

Me datën 10 shtator 2021, dite e Premte pushoj zemra e Kryerapsodit të Dukagjinit, Mhill Çun Gjonaj. Nje vdekje e parakohshme, por kjo eshte jeta!

Me datën 11 shtator 2021, në mjediset e Bar-Restorant "Orlando" u bë ceremonia e varrimit të tij, e përcjelljes për në banesën e fundit.

Në ceremoninë e varrimit ishin të pranishëm familjarë miq dhe koleg të Mhillit.

Ne emër te Shqoptës Atdhetare "Dukagjini", kryetari, Ndue Sanaj e N/kryetari, Prele Milani vendosen kurore pranë arkivolit të Mhill Çunit.

Në emër të Shoqatës Atdhetare Dukagjini mbajti fjalën mortore, kryetari i saj z Ndue Sanaj.

Në emër të kolegëve këngëtarë dhe rapsodëve mbajti fjalën mortore z. Kadri Fikaj.

Kurora me lule, komunikim me TV lokale nga shumë personazhe të botës të artit dhe folklorit.

E përbashkëta e çdo bashkëbisedimi ishte se z. Mhill Çuni, la një emër të nderuar në fushën e trashëgimisë kulturore shqiptare.

Mhill Çuni - si gjithmonë i bashkoj të gjithë, por kësaj here për ti dhëne lamtumirën e fundit.

Ja disa prononësime:

**Leke Kroj:** "Me dvet sot tane Dukagjinin / dy lumejt, Shalën e Kirin / deri ku bahen bashke me Drinin / ulin lot, qe kja jne për Mhillin / .... Dukagjin e krejt Malësia / kjane poeti e çiftelia / kush i njeu këngët e tija / vend me vend ka i bien Shqipni / .... Fjale me shkrua nuk s' asht vështire me gjet / as për mue, qe s' jam poet / ne histori gjate ke me mbet / i shalla tash e ke dheun e lehte".

**Mark Gjoka:** "Sa dhimbje! Po ikën shume para kohe kalorësi i fundit të këngës burimore shqiptare, bardi i shquar që i beri çiftelinë të bekuar në dorën e tij, krijues me përmasa legjendare, që ringjalli nga legjendat mitet e historinë, kreshniket dhe zanat, Shenjtët e lëmshin e tokës, lahuta e dashurisë Mhill Çuni. Tani jo vetëm ne, por edhe bjeshkët do ta kenë shumë të vështire të mësohen me mungesën e magjisë Mhill Çuni. Pusho në panteonin qiellor të artit Shqip, O Ati I Çiftelisë shqiptare, të cilën do të kalojnë mote e lotët për ty nuk do t'i thahen".

**Në revistën "FJALA", shkruhet:** "I është dhënë lamtumira e fundit njërit nga kantautorit më të spikatur që ka nxjerrë jo vetëm treva e dukagjinit, por gjithë veriu i Shqipërisë. Ndaj në këtë ditë dhimbje për mjeshterin e këngës Mhill Çuni, të afërm, miq dhe ish koleg i kanë bërë nderimet e merituar. Ka qenë një ditë trishtimi dhe dhimbje, por dhe krenarie që e kishin njeriun e tyre të afërmit e kantautorit Mhill Çuni, po kështu edhe ish koleg e artist të folkut. Të gjithë me lotë në sy i kanë dhënë lamtumirën e fundit kolosit të këngës dhe

folkut Mhill Çuni. Gjatë ceremonisë së homazheve ka qene njëri ndër bashkëpunëtorët më të hershëm të tij Kadri Fikaj, i cili i ka dhënë fjalën Kryetarit të Shoqatës Dukagjini z. Ndue Sanaj ... Po kështu edhe Kadri Fikaj, Jonuz Delaj e mjaft të

është e rëndë për gjithë botën e artit në Shkodër dhe me gjere ... me dhimbje e kanë përcjell Mhill Çunin edhe mjaft nga ish koleg e dashamirës të artit të tij".

**Gjovalin Prroni** (këngëtar): "Miq sapo mora lajmin e hidhur që u nda nga

caktohet nga kuleta, përujla puthadorë shalët e gjata, gjoksi i zbërthyer dhe bombat zjarrra ofensive!"

**Zani i Veriut** (radio): "Lajm i trishte: "Shuhet" gjigandi i këngës e muzikës folklorike, Mill Çuni. I jashtëzakonshëm si rapsod, me një zë karakteristik, interpretues brilant, instrumentist, autor këngësh, organizator spektaklesh, nder zërat më të dashur për publikun. Pushoftë në paqe artisti i skenës e ekranit Mhill Çuni!"

**Gëzim Brahusa** (TV Blu-Skay): "Lamtumire Kolosi i folkut shqip, Mhill Çuni!"

**Agustin Pëllumbaj** (këngëtar): "I pavdekshëm artisti i madhi Mhill Çuni!"

**Tom Sokoli:** "Paska ndërrua jete një yll i këngës pastër shqipe dhe që do të mbahet mend për këngët e tekstet tij, derisa të flitet shqip.

Lavdi Rapsodit të Kombit, pusho në paqe Mhill Çuni!"

**Nosh Ndreahaj** (ekonomist): "Lamtumire rapsodi i shqiptareve zani i kreshnikeve, besës, trimnisë, burrnisë e bujarisë që për afër 50 vjet skalite me gjurme që nuk shlyhen kurrë në Alpet e Shqipeve epiken e legjendës me vargje melodi e zanin tan të pastër e të amel si vete Shala



tjerë e kanë kujtuar ish kolegun e tyre, si njeriun që beri epokë në folklore ... Për të shprehur dhimbjen dhe trishtimin e kësaj lamtumire në një prononcim për mediat kreu i shoqatës Dukagjini Ndue Sanaj është ndalur... Ndërsa Jonuz Delaj nuk i mbanë dot lotët për humbjen e ish kolegut dhe mikut të tij të vjetër...Ndërkohe që Kadri Fikaj ka theksuar se kjo humbje

jeta artisti i popullit këngëtar Mhill Çuni. Ai na la pas pasurinë më të madhe që njeh folklori Dukagjinas e më gjerë, autori i dhjetërave teksteve dhe këngëve që këndohen në mbarë Shqipëri".

**Prele Milani** (historian, publicist e poet): "Lamtumirë Gojëmjalit i hiteve të zjarrra të Eposit madhështor të shqipeve. Turp: - Shkalla e hierarkike e vlerave për-





ku leve e u rrite! Lamtumire miku e vëllai jem! Pushosh në paqe!"

**Fran Kodra** (kantautor): "Sot i dhamë lamtumiren e fundit Ikonës së rapsodisë së Dukagjinit. Ishte një humbje e pazëvendësueshme për Folklorin Shqiptar. Unë pata fatin të jem pjese bashkëpunimit në shumë projekte si dhe ta kem mik shtëpie. Mhill Çuni ishte një zë shumë i veçantë i eposit tone burimor, ku të gjithë mësuam dhe morëm prej tij. Një krijues i patundur në kompozim dhe varg. Moderator i pare i folklorit tone tradicional duke i veshur ngjyrat dhe petkun e kohës. Ai u nda prej nesh duke lanë mitin e tij të pavdekshëm në këngët e tij brez mbas brezi si një pasuri e madhe e Dukagjinit dhe Kombit. I përjetshëm kjoftë kujtimi i jote. Pushosh në paqe!"

**Jonuz Delaj** (Rapsod e këngëtar): "I pavdekshmi i këngës së folklorit shqiptar, gjigandi i fjalës e këngës Mhill Çuni. Lamtumire Kolos!"

**Art-Kultura:** "Shuhet artisti i madh i folklorit shqiptar Mhill Çuni! Artisti, që populli e quajti legjende, mbylli sytë dhe u largua nga ne, u largua vetëm fizikisht, pasi Mhill Çuni me punën e veprën e tij do të mbete i përjetshëm në mendjen e zemrat tona".

**Florian Fusha** (historian): "Mhill Çun Gjonaj! Sot Dukagjini humbi një nga përfaqësuesit më të rëndësishëm të muzikës popullore. Mjeshtrin e madh, artisti i popullit Mhill Çuni. I lindur në lagjen Tongjonaj, Breglumi, Shalë, por i njohur në Dukagjin e më gjere për zërin e tij të veçantë që ja dedikoj gjithë jetën muzikës folklorike të Dukagjinit".

**Dukagjin, Dashnija Jëme:** "Mhill Çuni na iku! Legjenda e folklorit, kryerapsodi i Dukagjinit, artisti i papërsëritshëm Mhill Çuni u nda nga jeta!"

**Toplana Humor Poezi:** Lamtumire Legjendë! Vajtojnë zanat n' mal prej zorit / vajton teli i çiftelisë / për legjendën e folklorit / që për rrugë pa kthim asht nisë"

**Lulash Brigja** (poet): "U nda nga jeta Rapsodi Mhill Çuni, Krushku i pare i çiftelisë! MHILL ÇUNI, krijues, instrumentist dhe interpretues i virtuoz (Kantautor) për 50 vjet në gjitha momentet dhe manifestimet me gjeneralë të skenave të folklorit".

**Dukagjini i Shkodrës:** "U nda nga jeta Rapsodi Mhill Çuni, Krushku i pare i çiftelisë!"

**Pëllumb Vatnikaj** (këngëtar): "Mhill Çuni pushofshi në paqe, artisti i madh i Dukagjinit!"

**Zef Nika** (gazetar): "Mhill Çuni, këngëtar i madh i Dukagjinit shpirti të pushoftë në paqe!"

\*\*\*

Ju shprehim ngushëllimet familjes, të afërmeve, miqve dhe kolegëve të tij!

MHILL ÇUNI u nda nga kjo jete për të len të gjallë e të pavdekshme këngën e tij, emrin e nderuar si Krushku i pare i çiftelisë ...

Lamtumire Mhill Çun Gjonaj!  
Pushofsh në paqe!

**Ndue Sanaj,**  
**Prele Milani e Lulash Brigja**

# Lamtumirë kantautori i veçantë i Dukagjinit, Mhill Çun Gjonaj!

- Fjala mortore për Mhill Çun Gjonaj -

Të nderuar të pranishëm!

Jemi sot ketu për t'ju shprehur ngushëllimet në emër të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"!

Për ju, Pali e Fran Çuni, vëllezër të Mhillit!

Për ju, Lorenci e Oliveri, djemtë e Mhillit!

Për ju, Kristjana, Dranila, Valuta, Krajllica, vajzat e Mhillit!

Për ju, Sofie, Marie e Bardha, motrat e Mhillit!

Për ju të afërmeve e miqësi të Mhillit!

Për ju pjesëmarrës në këtë ceremoni mortore!

Sot jemi mbledhur për ti dhënë lamtumiren e fundit kantautorit të veçantë të Dukagjinit, Mhill Çun Gjonaj!

Kush ishte Mhill Çun Gjonaj?

Mhilli, lindi me 18 shtator 1950, në fshatin Breglumi, të krahinës së Shalës në një familje të nderuar në Dukagjin, Çun Nika e Drane Markja

Shkollën fillore e 8 vjeçare i përfundoi në fshatin e lindjes. Pastaj vijoi shkollën e mesme për veterinarë, në shkollën Profesionale Veterinare – Shkodër. Por ai, kishte një dhunti në një fushë tjetër, në atë të folklorit dhe jo vetëm për të kënduar, por dhe për të krijuar tekste të veçanta për kohën. Pra, Mhilli u bë rapsod dhe kantautor më me emër në gjitha trevat shqiptare:

Kryerapsodi i Dukagjinit më i spikatur i të gjitha kohërave dhe pa dyshim një nga zërat më autentik të çiftelisë në shkallë kombëtare.

Mhill Çuni dhe Sali Mani ngjiten si askush në pedestal këngën rapsodike Dukagjinase dhe të Malësisë së Madhe duke formuar së bashku bigën ma të lartë të flokut të çiftelisë në veri të Shqipërisë.

Mhilli, ishte një mriç me rrënjë të thella në folklorin shqiptar. Ai ishte nipi i Gjergj Mark Gurit dhe Kolë Mark Gurit- Laruat Kombëtarë, njeri në Shkodër dhe tjetri në Lezhë. Zëra të hershëm të radiofonisë shqiptare. Ndërkohë që gjyshja e tij, Zojë Mustafja ka qenë një nder vajtoresh më klasike të maleve shqiptare. Ajo ka mahitur At' Shtjefen Gjeçovin dhe At' Benardin Palajt, të cilët i referohen në studimin e tyre në fushën e folklorit.

Mhilli, ishte një talent i lindur me dhunti specialë, poetike, vokal të kristaltë, një zë sa kumbues aq të ëmbël që u bë e mbeti bashkëshoqëruesi më i mirë i perlave poetike, që i buronin nga zemra duke i rritur e kthyer në hitet më të dashura për veshin e zemrat e miliona shqiptarëve.

-Mhilli, u rritë së bashku me çiftelinë dhe në skenën e shtëpisë së Kulturës Breg Lumi, në të cilën ka kënduar që në moshën 8 vjeçare.

Mhilli, mjeshtër autentik i majave i dha flokut burimor jehonë në gjithë hapësirën mbarë shqiptare,

për mes valëve të "Radio Tiranës"; "Radio Tiranës për shqiptaret jashtë atdheut" e RTVSH. Ai ka marre pjese në qindra koncerte e manifestime folklorike në skenat brenda dhe jashtë atdheut, kudo që jetojnë shqiptaret, ndoshta si as kush tjetër në Zonën ku kumbon çiftelia janë memorizua në arshivën e flokut hite kombëtare të pa vdekshme 20 këngë, që nga kënga "Pret Stambolla Skënderbeun" e deri te kënga "Ka je nisë Turgut pasha". Reper-

TV1 Channel, Shkodër.

Themelues dhe drejtor artistik i eventit kulturor "Sofra e Dukagjinit".

Për këto vlera është nderuar me titullin nderi:

Në vitin 1983 dhe 1988, është fitues Laurat i festivaleve folklorike;

Në vitin 1996, fitues i çmimit "Rapsodi më e Mirë", në Takimin Kombëtar të Lahutarëve, në Lezhë.

Në vitin 2017, 'Qytetar Nderi' i Komu-



tori artistik i tij përfshinë mbi 250 kënge.

Mhill Çuni nuk ishte thjeshtë një rapsod, por së pari një poet i talentuar dhe duke qenë i tillë është nder Kantautorët e pare dhe pa dyshim më të talentuarit e kohës së tij.

Ai ka marrë pjesë në festivalet Folklorike Kombëtare të viteve 1978, 1983 e 1988. Në vitin 1982 kur ishte në Shtëpinë e Kulturës Breg Lumi, në bashkëpunim me muzikologun Robert Prendushin dhe Përgjegjësin e Kulturës Gjergj Çuni zbuluan dhe vunë në skenë Vallen burimore "T' Lekve", e cila shkoj dhe mori çmim kombëtarë në Gjirokastër.

Në vitet 1981-1990, drejtues i jetës kulturore e artistike në Gruemirë, Malësi e Madhe.

Në vitet 1999-2002, ideator dhe drejtues i spektaklit "Hitet Folklorike" në

nës Rrethina, Shkodër.

Në vitin 2017, nderuar nga Shoqata Atdhetare "Dukagjini", me titullin "100 vjet arsim e kulturë në Dukagjin"

Në vitin 2019, Çmimi "Krenaria e Sofrës së Dukagjinit".

Në muajin shkurt 2021, Kryesia e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", me mbështetjen e Kryetares së Bashkisë Shkodër, zonjën Voltana Ademi, i ka propozuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë, për ta dekoruar me urdhrin "Mjeshtër i Madh".

Mhill Çuni u nda nga kjo jete për të len të gjallë e të pavdekshme këngën e tij emrin e nderuar si Krushku i pare i çiftelisë!

Në emër të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" dhe në emrin tim, ju shpreh ngushëllimet familjes, të afërmeve, kolegëve e miqësisë! Ju paste lanë jetën, mbarësinë e mirësinë në jetën tuaj!

I lehtë të qoftë dheu Kantautori Mhill Çun Gjonaj

I paharruar vepra e kantautorit Mhill Çun Gjonaj!

Lamtumire kantautori Mhill Çun Gjonaj!

**Ndue Sanaj,**  
Shkodër, më 11 shtator 2021





# LAMTUMIRË GOJËMJALTI I HITEVE TË ZJARRTA TË EPOSIT MADHËSHTOR TË SHQIPEVE

**Turp: Shkalla e hierarkike e vlerave përcaktohet nga kuleta, përlja puthadorë shalët e gjata, gjoksi i zbërthyer dhe bombat zjarrta ofensive!**

Në ketë ditë me dritë hije të 10 shtatorit 2021 prani zëri i bilbililit të rapsodive moderne shqiptare. Sot ndaloj për gjithmonë një zemër nder me te mëdhatë që ushqej me dashuri të pa kushte për 50 vjet folkun tonë. Instrumenti me dy tela humbi sot mjeshttrin e majave dhe prijësin e saj të ndritur. Mëhill Çuni mblodhi në rapsoditë e tij mjaltin e bletëve që thithin vesën nder lulet e dëlira te melosit tonë kombëtarë. Zani i Mehill Çunit buronte i plotë i butë i dashur parësore ishte fjalla pastaj tingulli por në një harmoni të shkëlqyer mes vargut dhe muzikës. Pavarësisht lëvizjeve turbulluese, politike, ideologjike fetare tek shqiptarët, pleq e te rij qofshin, ju sollët ujë të bollshëm gurgullues në mullirin e atdheut. Këngët e gojëmjaltit Mehill Çunit të qëndisura poetikisht dhe të ngujuara në besnikëri stërgjyshore ishin marshe të zjarrta fluturake dashurie, lavdie dhe përjetësie për fatosat e kombit

Krijues, instrumentist dhe interpretues i virtuoz (Kantautor) për 50 vjet në gjitha eventet dhe manifestimet me gjeneralë te skenave te folklorit

Krye parik i rapsodisë Dukagjinase më i spikatur i të gjitha kohërave dhe pa dyshim një nga zërat gjeneral të çiftelisë në shkallë kombëtare.

Mëhill Çuni dhe Sali Mani e ngritën si askush në pedestal këngën dukagjinase dhe të Malësisë së madhe duke formuar se bashku bigën ma të lartë të flokut të çiftelisë në veri të Shqipërisë.

Mëhill Çuni nuk ishte një lule nga hiçi. Ai ishte nipi i Gjergj Mark Gurit dhe Kolë Mark Gurit Leurat Kombëtarë njeri në Shkodër dhe tjetri në Lezhë. Eter te vjetër flokut të zërat më hershëm të radiofonisë shqiptare.

Ndërkohë që gjyshja e tij Zojë Mustafja ka qenë një vajtoreset me klasë të Lekisë që ka mahitur At Sh Gjeçovin dhe At' Benardin Palajt, të cilët e kanë intervistuar dhe i referohen në studimet e tyre në fushën e folklorit Ajo për shigjetat e zjarrta arkaike që lëshoj kundër dhunës diktatoriale ndaj klerit nacionalistëve dhe njerëzve te pa fajshëm u dënua dhe u internua politikisht nga diktatura komuniste.

Mehill Çuni ishte një talent i lindur me dhunti specialë, poetike, vokal të kristaltë, një zë sa kumbues aq të ëmbël që u bë e mbeti bashkëshoqëruesi më i mirë i perlave poetike që i buronin nga zemra duke i rritur e kthyer në hitet më dashura për veshin zemrat e miliona shqiptarëve.

Mëhill Çuni u rritë se bashku me çiftelinë dhe në skenën e shtëpisë së Kulturës Breg Lumi ka kënduar që në moshën 8 vjeçare.

I joshur nga rapsodi veteran Fran Pali dhe daja i Gjergj Marku, Mehill Çuni nuk do të ndahej më çiftelisë në festa gëzime dhe aktivitete artistike që ishin periodike dhe shpeshta.

Kishte dëshirë të vazhdonte për muzikë por biografia e përshtatshme ju bë pengesë në fushën e shkollimit dhe karrierës artistike.

U arsimua për veterani dhe as një ditë nuk ju nda jeta kulturore e artistike.

Një temperament i vështirë kolerik, anti konformist, por shumë i talentuar vrapoj pa u ndalur në një pistë me pengesa të përhershme dhe arriti të kapte majat.

Si mjeshtër autentik i majave i dha flokut burimor jehonë në gjithë hapësirën mbarë shqiptare, për mes Valëve të "Ra-



dio Tiranës"; "Radio Tiranës për shqiptaret jashtë atdheut", RTVSH

Ka milituar në qindra, koncerte, tubime e manifestime folklorike në skenat brenda dhe jashtë atdheut, kudo që jetojnë shqiptarët

1-Mëhill Çuni ndoshta si as kush tjetër në Zonën ku kumbon çiftelia ka memorizue në arshivën e flokut hite kombëtare të pa vdekshme të tilla si

"Pret Stamballa Skënderbegun".

"Shtatë shaljanët".

"Moj Kosovë Mriz me zana".

"Kanë nisët bjeshkët fort po dridhe" (Ngjarje në Kosove 1982).

"Kaluan Shekujt"(Kryengritjet me mëdha patriotike 1910-1911-1912).

"Po var pasha një burë prej Shale". (Motivi madhështorë i bujarisë)

"Djemtë e shqipes".

"Bahem shkamb te guri i praku" (Kushtuar Prekë Calit).

"Kjo Shqipni që njeh gjithë bota".

"Has Prishtina".

"Mehmet Shpendit".

"Xhur Kola dredhi shallen".

"Deli Pjetri".

"Kolë Mark Kola".

"Zef Hotit" (Dëshmorit antifashist në Luftën e Spanjës).

"Heroinat shqiptare".

"Dukagjini 9 vullkane mbushë me flake".

"Në atë pranverë kur shkrinë bora".

"Ç' djem kanë Rritë trojet e Hotit".

"Ka je nisë Turgut pasha".

Repertori artistik i tij përfshinë mbi

250 këngë

Atdheu, fatosat më shquar të tij, ngjarjet lapidare te historisë, Kosova e robëruar që kërkon liri, besa, bujaria, heroina e nënat shqiptare e dashuria e dëlirë janë tematika që pikasi, i qëndisi, u dha krahë dhe ja la trashëgimi brezave.

2-Mëhill Çuni nuk ishte thjeshtë një rapsod por së pari një poet i talentuar dhe duke qenë i tillë është nder Kantautorët e pare dhe pa dyshim më të talentuarit e kohës së tij.

Tekstet e Mehill Çunit janë poezi me

Malësi e Madhe duke ngritur një nga Ansamblet me efektive dhe me të suksesshme të Shkodrës.

Ansambli kishte grup instrumental, solist të spikatur., kor, grup vallesh dhe grup të fëmijësh. Ky ansambël i larmishëm kishte vulën pasionit dhe punës profesionale të Mehill Çunit

10- Nga vitet 1999-2002 në TV 1 CHANNEL, ka qenë ideator, realizues dhe drejtues i spektaklit gjurmë lënës javorë "HITET FOLKLORIKE në cilin janë prezantuar zërat me të mirë të Veriut, Kosove, Maqedonisë dhe treva shqiptare në Mal të Zi e diasporë.

11- Është Themeluesi dhe Drejtori artistik eventit kulturor "SOFRA E DUKAGJINIT" e para në Rrethin e Shkodrës me një aktivitet të rregullt artistik të kthyer në traditë pa ndërprerë 22 vjeçare.

Duke qenë se rrjedhtë nga një familje e persekutuar as një herë nuk u vlerësua për kontributin e dhënë. Në fillimi të Lëvizjeve demokratike ka qenë nder aktivistet e parë opozitare në Rrethin e Shkodrës.

Jeta e Mehill Çunit ishte një det i trazuar si një stinë me diell vranësira, stuhi e furtunë

Jeta e Mehill Çunit ishte një urate poetike muzikore një maratonë e gjate vlerësuar më notat më larta ne zemrat e shqipeve këngëtare. Mehill Çuni nuk meritonte të vdiste i vetmuar si njeri i harruar dhe i mos përfillur nga politika dhe as një instance shtetërore,

Nëse që gjithë bashkëkohësit e tij të kateve të më poshtme u dekoruan me titujt artistik më lartë, për rebelin e pa ndreqshëm njeriun që nuk dinte përkulej as te shtrinte dorën Mehill Çuni nuk u kujtua as një njeri

Në Shqipëri vijon maskarada shumë seriale ku shkalla e hierarkike e vlerave përcaktohet nga kuleta, përlja puthadorë ndaj politikës, shalët e gjata, gjoksi i zbërthyer dhe bombat ofensive përvëluese.

Në se ka jetë si thuhet Mehill Çuni sonte nuk i behet gjamë, por një dasmë e madhe me gjeografi kombëtare ku presin gjithë armata bilbilave që prehen në amshim duke filluar nga Dervish Shaqja, Qamili i Vogel, Fatime Sokoli, Tomë Nikolla, Ndue Shyti, Hazis Ndreu, Frrok Haxhia, Sali Mani, Kol Buçi, Gjini Shkoza, Syk Pappleka, Fran Pali, Arben Deda e të tjerë e të tjerë.

Në se ka jetë si thuhet Mehill Çunin do ta presin krahëhapur me kurora me dafina armata e dëshmorëve të atdheut, që i memorizoi në këngë pavdekësie.

Lamtumirë gojëmjalti i hiteve të zjarrta të eposit madhështor të shqipeve!

**Prele Milani**

9- Nga vitet- 1981-1990 ka qenë drejtuar jetën kulturore artistike në Gruemirë,



# KOLË PROGNI - SHOQIPJA E ALPEVE SHQIPTARË

- mbresa nga një veprimtari -

Kaloi mbi një vit që Kolë Progni kaloi në amshim. U ngjit atje lart, në qiell, plot krenari për jetën e tij toksore, ashtu siç dinë të ngjiten burrat me mend. Se kur na vjen kjo ditë nuk e dimë, dhe mirë që nuk e dimë, por për këtë ditë duhet të përpiqemi dhe përgatitemi vazhdimisht. Kështu bëri dhe ja arriti, profesori i nderuar Kolë Progni. Nuk e donim, asnjë besoj, që të vinte kjo ndarje kaq pa prituri, kaq e shpejt dhe pa pasur mundësi që ti bëhej një përcjedhje e merituar, ti hillej një grusht dhe mbi arkmortin në banesën e fundit të tij.

## Kjo ditë gushti...

Në një ditë gushti të këtij vitit, në "Orlando", një mjedis nga më të mirët në qytetin tonë, mblidhen shumë burra e gra, intelektual e njerëz të thjeshtë, të rinjë e të reja. Ata vinë nga, Shkodra e Dukagjini, Nikaj-Mërturi e Tropoja, nga Tirana, nga Gjakova e vise të tjera të Kosovës, vinë miq të shumtë nga të gjitha vendet ku profesor Kola ka punuar e jetuar.


Në këtë ditë Kolë Progni mbushi një vitë që është ndarë nga jeta, por ka edhe një publikim të një vepra studimore për Nikaj-Mërturin studimi mbi të cilin kishte hedhur mendimet dhe fjalët e fundit, por nuk arriti që ta shikonte të botuar. Kjo e bëri këtë veprimtari edhe më të dhimshme por edhe më optimiste. Salla është mbushur plot. Ka vëmendje të madhe, por nuk mungojnë duartrokitjet e falnderimet, kujtimet, vlersimet përjetën dhe punën e Prof. Kolë Prognit. Sjellin kujtime e vlerësime bashkëpunëtor, shokë e miq, intelektual, bakëkrahinarë, mësues e ish nxënës të profesor Kolës.

Fran Ukicama në përshëndetjen e tij thotë midis të tjerash se ka monumente, lapidarë, harqe triumfi, muze, që ngrihen në mermer, por që i bjerr koha, i mbulon bloza, hirri harresës, por kamonumente që shkriehen me frymë, shpirt, fjalë, vepramonumentale që kurr nuk zbehen, jetojnë në breza, shkëlqejnë në kalim motesh. E tillë është dhe mbetet jeta e Kolë Prognit. Kolë Progni mbetet një Ershell legjendar. Ai, lavdinë e firmosi me qindra botime, qindra referime, me dy botime të karakterit enciklopedik. Ai hyri vrullshëm dhe mbeti mriz në histori, shkruan Fran Ukicama.



Në Shpellën e Jubanit

E studiuesi Gjakë Sokoli nga Gjakova, por edhe miku i prof. Kolës, kujton ditën kur u takuan në vitin 2020, pak kohë përpara se të ndrronte jetë dhe i drejtoi



Kolë Progni 1944-2020

pyetjen: Çka të ka shtyrë për të studiuar Alpet dhe zonën e Nikaj-Mërturit, dhe përgjigjia ishte: "...vendlindja në Alpe, dashuria për mjedisin ku jam lindur, për traditat, për vuajtjet që përjetoj kjo trevë e Malësisë së Gjakovës. Në këtë drejtim më ka shtyrë edhe Universiteti përgjeografi. Gjithashtu pasioni dhe nxitja që të punoj në këtë drejtim janë edhe studiuesit shqiptar si Pandi Gaqo, dhe veçanërisht studimet e Franc Nopçës me mbi njëqind vepra për Shqipërinë. Këta por edhe të tjerë më nxitën që të jap edhe unë një ndihmesë. Veçanërisht u frymëzova që të punoj dhe ndriçoj, sa të mundem, rrënjët e trevës Nikaj-Mërturi..."

Në çdo rresht të kësaj monografie të



Kolë, Gjin dhe Marie Progni

Kolë Prognit, për Nikaj-Mërturin, shikohet qartë përkushtimi i tij dhe atdhetarizmi, i këtij studiuesi të pashoq, i cili pati aq durim dhe dashuri për të kontribuar me këtë libër kaq voluminoz dhe me vlerë që e bën lexuesin për vete. Profesor Kolë Progni shkruajti librin për Nikaj-Mërturin "Nderi i Kombit", dhe vetë është dhe do të mbetet "Nderi i Nikaj-Mërturit", do të përfundonte fjalën e tij gjakovari Gjakë Sokoli.

Dr. Dedë Qokaj shkruan: "Sot do të kishim dashur kjo akademi e merituar, të ishte në sinkron me profesorin e Alpeve Shqiptare, që të na shihet dhe ta shihnim sy për sy, që vepra e tij e pavdekshme të frymonte bashkë me ne, Hyji i Gjithëpushtetshëm i vendos vetë ditët dhe vitet tona. Ai iku atje ku shkojnë të gjithë vdekatarët, por la pas një trung familjar të mrekullueshëm, dhe një vepër shkencore që do tu shërbejë shumë brezave si burim i përherëshëm reference". Dhe zoti Qokaj do të vazhdonte se në këtë monografi të Profesor Kolës rrezatojnë tëra ngjyrat e ylberit, gjeografiko-shkencore të Tij në disa fusha si, gjeograf i talentuar, historian, biolog, etnograf, folklorist, alpinist dhe eksplorator i Alpeve, onomasticien i kujdeshëm, leksikograf, bibliograf, fotograf, speleolog, etj, e duke e mbydhur ligjerimin e tij zoti Dedë Qokaj jep vlerësimin e meritur për profesor Kolën me fjalët: "...punove në mënyrë të përkryer, o mjeshtër".

Kolë Progni krahas punës mësimore, rrugtoi nëpër Alpet Shqiptare duke bërë afër 7000 km në këmbë. Dhe kjo është një veçori që nuk e ka arritur asnjë studiues i Alpeve deri në sot.

## Marie

Në këmbë, në krah të tavolinës kryesore, qëndron e heshtur Marie, bashkëshortja e Kolë Prognit. Ajo nuk pranoi, më mirë me thënë munda të përbadhë uljen përbadhë atyre njerëzve nga përmadhimi dhe ku mungonte përgjithmonë prania fizike e bashkëshortit të saj. Disa herë u ngrit nga vendi ku qëndronte Gjin Progni për të bërë të mundur që edhe Marie të ulej në tavolinën kryesore të kësaj akademie përkujtimore dhe shkencore, por nuk qe e mundur. Edhe aty ku kishte zënë vend nuk qëndronte ulur por gjatë gjithë kohës në këmbë. Në dorë mbante një shami me të cilën herë fshinte lotët, herë fshinte djersët, pavarësisht se mjedisi ishte i frekët. Secilin që merrte fjalën e dëgjonte plot vëmendje. Përkrah saj kishte disa njerëz, por veçanërisht kunati i saj, vëllai i vogël i Kolës, Marku, i cili kishte ardhur posaçërisht për këtë veprimtari nga Greqia ku jeton.

Momente të paharrueshme ka shumë, thot Marie, kur e pyeta për ndonjë gjë të veçantë të Kolës, por po përmend ndonjë të pa përmendura. "Fëmijët e të gjitha moshave e kanë dashtë e respektue shumë, por edhe ky i ka dashtë shumë, p.sh. gjatë vjeshtës në Tamare i binin fruta, e ai ju thoshte, leni tek tavolina dhe në fund të mësimit i thoshte kujdestares së klasës, ndajua të gjithëve, ose kur kalonte Kola e linin lojën me top dhe e rrethonin e bisedonin me të. Ka rastisë me shkue



Marie dhe Kolë Progni

miq në familjet kojshi me ne, dhe për të liruuar dhomën, fëmijët i sillnin tek ne, kaq shumë e donin Kolën sa nganjëherë ndonjënjëri i thoshte a bahem çika (djali) e xhaxhi Koles për gjithëmonë, etj. Asnjë herë nuk ngopej kur shkonte mik, kjo jo se nuk kishte ushqim në sofër apo tavolinë, por për të respektuar familjen dhe nga ana tjetër njëjthe mirë gjendjen ekonomike të familjeve. Nuk kishte qejf me hagër një gja të mirë vetem, pa miq. Shpesh thoshte që miku asht tanë nafakë". etj.

Megjithë vështirësitë psikologjike nga humbja e bashkëshortit, Marie, ju përvesh punës që të organizonte përgatitjen dhe



botimin e librit që Kola kishtë lënë gati. Ju gjetën pranë Gjini Progni, kushrini i parë i Kolës, vëllezërit e Maries, Kadri Fikaj shok e dashamirë i Kolës, shtëpia botuese "Fjorentia", etj. Maria, në bashkëpunim me të afërm të Kolës, kishin merak dhe donin që libri të dilte në datën që Kola u nda nga jeta, por edhe për të organizuar një përkujtimore në këtë ditë pasi kushtet e pandemisë nuk e lejuan që të përcillej në ditën e varrimit siç e meritonte. Ky objektivi u realizue shumë mirë.


Maria është bijë e Shoshit fisnik. Janë njohur me Kolën rastësisht në Breglumi-Shalë. Në këtë moment, Kola ishte me një shok të tij nga Shoshi, Gjon Shtegun. Maria ka dajat në Mërtur dhe këta pastaj kanë ndihmuar afrimin e tyre dhe lidhjen e martesës. Kanë jetuar bashkë për 47 vjet. Një çift model.

Në mbydhje të kësaj veprimtare Maria përshëndeti dhe falnderoi të pranishmit me fjalë zemre.

**Biblioteka dhe arkivi**

Në shtëpinë që kanë banuar, në një nga dhomat më të mira, është një bibliotekë dhe një kabinet punë shumë i sistemuar, i plotë për të studiuar. Gjithë faqja e dhomës është e mbushur me libra, të vendosura bukur, të mundura për tu orjentuuar shpejt për gjetjen e librit të kërkuar.

Afër 2000 libra janë në fondin e kësaj biblioteke. Tavolina, kompjuteri, harta, fotografi të ekspozuara në faqet e murit, kudo nëpër shtëpi, sirtarë të mbushur plot me fotografi e negativa. Arkivi i Kolë Prognit ka mbi 20.000 foto bardh e zi dhe me ngjyra, CD etj. Unë kujtoj një takim në Theth, në fillim të viteve '90, kur u futën në masë fotot më ngjyra. U takuam dhe pyetëm dhe uruam njëri tjetrin. Ishte me një çantë në dorë. E pyes se për ku ishte nisur. Ai më thotë se do të shkontë në Bjeshkët e Majapjës, më shumë për të bërë disa foto më ngjyra. Kam shumë foto bardh e zi, por do të përpiqem që ti dubloj me ngjyra. Studiues i palodhur, skrupuloz shumë i vëmendshëm. Profesor Kolë shkaj në amshim por ka lënë pas një pasuri të madhe intelektuale. Përvç botimeve të publikuara ka lënë pothuaj gati për botim 1.Një jetë në Alpe, 2.Toponime të Alpeve, 3.Lexime Gjeografike, 4.Album



fotosh bardh e zi dhe me ngjyra.

**Fjala e pa thënë...**

Gjin Progni, kushriri i parë dhe shumëwdashamirw, në ditët e ndarjes nga jeta të Kolës, në një elegji shumë prekse shkruante:

"...T'tanë ditën shkulma zjarr-dielli mora me djegë vdekjen,

Se nuk duroj gjamë në sinorët e dheut tim,

Por vdekja s'paska vdekje vëllau im, o vlla.

Që sot, me vdekjen n'gjak do jem përjetë vëllau im, o vëlla..."

E poeti Marash Lekndreaj, ato ditë që Kolë Progni mbydhë përgjithmonë, në një elegji shumë të ndjerë dhe të thellë, në mes të tjerash do të shkruante:

"...Diell i nadjes, a i mbramjes, A loton e bukra hanë, Për kë ishte loti i fundit, Cila fjalë të mbet pa thanë?..."

Njeriu në jetë ka shumë takime, përdorë shumë fjalë, sa që ndonjëri mund të mendojë se i ka dëgjuar të gjitha, por

poeti, mbase, ose të paktën unë kështu mendoj, e ka fjalën për një fjalë që vërtetë i mbeti pa ju thënë. Është ajo fjalë që do të dëshironim të gjithë që ti thuhej, por jeta është e till dhe duhet ta pranojmë. Kjo është fjala "babë". Çifti Kolë e Marie nuk patën trashëgimtar, një brengë e madhe për këdo që formon familje. Por Kolë Progni la një trashëgimi të madhe e të pazvendësueshme me punën e tij. La një trashëgimi të pavdekshme me mendjen e tij, me dorën etij, me pendën e tij. Ai la një trung familjarë shumë të mirë me burra e burrnesha, me djem e vajza, intelektual dhe puntorë të talentuar, e që Kola do të jenë i pranishëm gjithmonë në mendjen dhe zemrat e tyre.

\*\*\*

Po më pëlqen ta përsëris një pasazh nga çfarë kam shkruar për Kolë Prognin në ato ditë që u nda një jeta. "Ai, do ti mungojë kabinetit tij të punës, tavolinës së intelektualëve, tavolinës së kuvendimit shoqëror, odës malsore, bjeshkës e vrrinit, malit dhe fushës, nxënësit dhe studentit, gëzimeve dhe hidhërimeve, bisedave plot humor e dashamirësi, do tu mungojnë pleqëve në takime të rastësishme dhe të planizuara, do të mungojë në studio e para kamerave a mikrofonëve, në sesione e trajtime shkencore, në promovime li-brash, e shumë e shumë të tjera. Por Profesori do tu mungojnë atyre që mëndjen dhe zemrën ua pati vënë në dispozicion, Alpeve Shqiptare. Kjo vetëm fizikisht".


Po i mbydhë këto mbresa me disa vargje të zotit Marash Lekndreaj

"...Profesor, pusho i qetë, Shpirti yt i gjanë si det, Si fllad bjeshke ke me mbet, T'çon Zoti, ku t'duash vet..."


\*\*\*

Në mbydhje të kësaj veprimtarie përkujtimore dhe promovuese, Dr.Mhill Gecaj kryetari i shoqatës Nikaj-Mërtur, i ka dorëzuar bashkëshortes Marie, titullin; Kolë Progni - "Nderi i Nikaj-Mërturit".

**Luigj SHYTI**  
gusht, 2021



Vëllezërit Dodë e Kolë Progni



Në vendlindje



# Vaksinimi kundër Covid-19, disa përgjigje për çështjet që shtrohen, kur hezitoni të bëni vaksinën

Pas variantit Delta (D), tani Evropa po përballet dhe me varantin e ri Kolumbian Kapa (K), ose MU (3 rastet e vërtetuara në një Azil pleqsh në Belgjike) raportohet se ka raste dhe në Greqi. Si në gjithë Evropën dhe në vendin tone, që 15 korrik 2021 është vendosur nga ekspertet infeksionist dhe Ministria e Shëndetësisë, që i gjithë kontingjenti e popullsisë mbi 18 vjeç të futet në skemën e vaksinimit Ati-Covid-19- dhe 30% e popullsisë ka bërë të paktën 1 doze. Tani po ndalemi në disa çështje më të përgjithshme, të cilat na çojnë në refuzimin (hezitimin) e vaksinimit, ose për zgjedhjen e kohës ndërmjet dozave:

1- Shumë shpejt, për të garantuar siguri, Vaksina është zhvilluar. Sipas të dhënave të FAA-të SHBA (Justin Tallis-AFP), e cila me 17.12.2020 ka publikuar përbërësit e Vaksinës Pfiser e të Bio-NT-ech-, ku shprehet se është përdorur një teknike e re me ARN-m (ARN-mesazher), për tu mbrojtur nga SARS-Cov-2 përgjegjës për Covid-19. ARN-m ose principi aktiv kryesor (qendror) i kësaj vaccine, në sajë të tij organizmi do mësohet të luftoj virusin në fjalë. Porcioni ARN-m bën që të prodhohet një proteinë "Spikes" në organizmin e vaksinuar, në sajë të së cilës virusi na infekton. Dilet në përfundimin, se pacienti i vaksinuar mëson organizmin të prodhojë copëza të vogla inoffensive të virusit. Pra, bën një fare shënjestre trajnuese, që kur organizmi ynë sulmohet dendur nga virusi i vërtet në vijim do të dije dhe ka mundësit të mbrohet kundër tij, është në të njëjtën linjë me vaksinat tjera, që ato nuk përdorin ARN-m, por pjesë virusi inaktiv, të dobësuar. ARN-m ka gjithë kohën e duhur të transmetojë "planin konstruktiv" para se të zhduket. Siç dihet ARN, është në lende fragjile shumë e pa qëndrueshme, ajo qëndron në trupin tone nga disa ore deri në disa dite maksimum--shpjegohet nga shkencëtarët si Bruno Pitard et bp. Dhe asnjë rrezik nuk paraqet ARN-m për ndryshime gjenetike në trupin e njeriut-nuk është e mundur të beje ndryshime gjenetike në AND tone-në se behet vaksina me ARN-m. Dihet se, ARN-m mbetet në citoplazmën e qelizës (dhoma mes bërthamës dhe membranës qelizore-ARN-nuk mund të hyj në bërthamën qelizore ku gjendet ADN, nuk ka ndërveprim midis ADN-s tone dhe ARN-të virusit, që injektohet. Dhe vete ARN-nuk mund të mbijetonte, e nuk do të ishte efikase në se nuk mbështillet me një zarf mbrojtës lipidik, që zgjidhen në funksion të ngarkesës elektrike deri sa përzërja të jete në ekuilibër-lipid kationik (+pozitiv-ndrl), që shoqëron ato të ARN-negative (-). ku të dy ngarkesat mbahen në ekuilibër. Pra, probleme teknike të imta-për të mbajtur një solucion homogjen e të qëndrueshëm, për të evituar fuzionimin. Por publikimi i përbërësve të vaksinës zhduk çdo iluzion të teorive konspirative-dhe jep mundësi të shmanjen në minimum reaksionet alergjike, ose papajtueshmëritë me përbërësit e vaksinës. Çdo person para vaksinimit lexon


një formular për përbërësit vaksinal dhe i merret një anamneze intime për reaksionet e ndryshme individuale e familjare dhe vihet nën vëzhgim pas vaksinimit për rreth 30 minuta-

Në princip, venia në veprim e një vaccine kërkon shumë vite. Ketë here, kjo u krye në më pak se 1 vit, pra (zbulimi i agentit të ri -Corona-virusi SARS-Cov-2 dhe zhvillimi i vaksinës së pare, gjë e pa pare kurrë ndonjë here më pare. Megjithatë, po ashtu është për tu çuditur dhe mundësia e sigurisë si dhe efikasitetit, që janë testuar sipas rregullave të artit të provave klinike. Do të thotë, ne tre faza vijuese njëra pas tjetrës:

a-Së pari, observimi i toksicitetit të një infeksioni në numër të vogël personash

b-Evoluimi i përgjigjes imunitare në një tjetër grup pacientesh.

c-Testimi në shkallë të gjere i efikasitetit të vaksinës në mbi 30 000 persona për vaksinën moderne nga instituti kombëtar i shëndetit Amerikan dhe mbi 40 000 veta për laboratorin Pfiser. Në këtë aspekt klinik diferenca në procesin klasik është nxjerrja e fakteve të mbulimit të mirë të etapave të ndryshme. Në vend, që të pritnin rezultatet finale të çdo faze para



se të organizohet faza vijuese, protokolohen dhe rekrutohen te tre fazat, që do të thotë janë lancuar në të njëjtën kohë. Për te gjitha çështjet, që ju shqetësojnë për vaksinën anti covid-19 ju mund të kontaktoni në twitch-tv"-Science et Avenir". Shpejtësia, me të cilën u realizua në një kohë rekord, ka ardhur në sajë të marrjes së riskut logjistik dhe financiar në një kooperim historik midis laboratorëve, qeverive e autoriteteve shëndetësore dhe investuesve faraonik. Më së fundi mund të themi se:- që prej vënies në veprim të vaksinës dhe në vijim provat nuk janë ndërprere dhe sot janë në fazën e 4 (katërt) të farmokovigjilences, që po ndiqet nga autoritet shëndetësore. Kjo lejon të zbulohen shpejt efektet e padëshirueshme të rralla si tromboze venoze për vaksinën Astra Zeneka. Me 3 qershor 2021, në France janë aplikuar afër 24 milion doza të vaksinës Pfiser me 20 987 raste të efekteve anësore d.m.th.

0.09% të të gjitha rasteve.

2-Teknologjia e ARN-mesazher (ARN-m) është më e fundit. Vëmendja përqendrohet mbi risinë teknologjike të vaksinës ARN-m, të paktën mund të referojnë se metoda ka premtuar në një numër fushash terapeutike. Teknologjia e vektorit viral për të prezantuar antigenin vaksinal sigurisht për një afat të gjate, por asnjëra prej tyre (Astra Zeneta, ose Janssen) nuk është shpalosur në shkallë të gjere. Kështu efikasiteti dhe siguria e vaksinës ARN-m mbetet superior mbi vaksinat adenovierus, siç u shprehëm më sipër.

3-Sa e sigurte është Vaksina, a do te ketë efekte afat gjate mbi organizmin tone. Pas mbi 20 muaj të kësaj pandemie, që sipas raportimeve ka nga 3,6 deri 6,9 milion viktima, efekti afat gjate i një infeksionit-SARS-Cov-2 i demonstruar apo asimptomatik janë të gjitha të pa njohura. Një infeksion viral mund të ketë pasoja afat gjate - mund çoj në shpërthimin e sëmundjeve autoimmune tek te predispozuarit ose çon vite më vonë në shfaqjen e kacereve si papilloma virus human, kancer i qafës së mitrës e të tjerë. Por vaksina nuk ka asnjë efekt afat gjate. Pra, të dhënat janë si kontroversi

janë eliminuar epidemitë e - si Lija e verdet (variola), fruthit, difterisë, pertusit, ru-beola, poliomyeliti, ethet e verdha, pneumokoku-Tuberkulozi(TBC) e të tjera.

5-A pengon vërtetë transmetimin e viruset vaksina Anti-Covid?

Sot, kjo është sqaruar më mirë ...- që në muajin mars të 2021 sipas "Science et Avenir", që ndoqi miliona persona që kane marre 2 doza të vaksinës me ARN-m "Pfiser" ku u vlerësua një ulje e rrezikut të transmetimit të virusit nga 75-90%. Në Izrael ku ka shërbyer laboratorin Pfiser në fakt një shoqëri vaksinimi masive, kërkuesit e saj treguan se vetëm persona te veçantë u infektuan brenda 12 ditëve ose me vone nga vaksinimi dhe paraqiten një pakësim domethënës të ngarkesës virale duke u bere si përjashtim rrezik për infektim tek të tjerët. Si përfundim bllokimi I infeksionit dhe i transmetimit të virusit nuk mund te themi se është plotësisht i sigurte, sado që ka shumë efikasitet. Nëse behet vaksina është fakti i njohur se ndërpritet zingjiri i transmetimit dhe pengohet qarkullimi i virusit.

6-Cili është interesi I vaksinimit për një të rritur me një shëndet të mirë, i cili nuk paraqet apriori faktor rreziku të formës së rende?

Së pari, është interesi i përgjithshëm. Është kënaqësi, sadifaksion të jesh një person që nuk kontribuon në qarkullimin e virusit, i cili mund të preke persona të pa vaksinuar si pacient imunodeficitar, ose alergjik, që u kundër ndikohet vaksinimi. Në nivelin individual përfitimet mund të ngjasojnë më të vogla. Megjithatë, në vështrimin e rrezikut të vaksinës dhe të një infeksioni të quajtur benignë përfitimi nga ana statistikore është gjithnjë në favor të vaksinës, nga që nuk dihet a është i predispozuar një person me shëndet të mirë, a mund të kaloje një infeksion të rende covid apo kalon simptoma presistente si "Covid- long" pra i zgjatur, që prek të rinjtë me shëndet të mirë.

7- A ka rrezik gruaja shtatzënë nga bërja e vaksinës anticovid? Nuk ekziston asnjë kundër indikacion për të bere vaksinën gjate shtatzënisë ashtu si vaksina TBC Fruth, Rubeole, Patriotit, LIJA (variola) janë po ashtu të rekomanduara. Ndërkaq vaksina anticovid me ARN-m (e Pfiser, moderna) është shumë e sigurte thekson prof. Weil Olivier pediater dhe anëtar i infovac. Vaksina anti-Covidit ngjason po ashtu të ketë efekt mbrojtës, që ndihet deri tek fetusit sipas specialisteve, sepse antikorpet IgG kundër Sars-cov-2 transmetohet me ane të placentës (pra, përshkon barrierën placentare), që me 01/07/2021, në 27 vende të BE, është e detyrueshme certifikata e garancisë shëndetit anticovid, gjë e cila dhe në vendin tone është e shpallur për të gjithë personat e vaksinuar në e-albania, e cila mund të nxirret nëpërmjet kartës së inditetit të çdo personi.

Përgatiti: **Dr.Med.Ndue NIKAJ**  
Shkodër



# KËNGËTARI I MALËSISË NIKOLLË NIKPRELAJ, BURIM I PASHTERSHËM DHE PËRÇUES I VLERAVE TË MËDHA ARTISTIKE

Një rajon me vlera të mëdha etnokulturore dhe historike është edhe krahina e Malësisë së Madhe, e shtrirë në Veri të qytetit të Shkodrës, deri thellë në luginat dhe majat e thepisura të Alpeve, por që fatkeqësisht e cinguar nga padrejtësitë e historisë. Kjo krahinë andej dhe këndej kufirit edhe pse e ndarë gjeografikisht ka trashëguar vlerat e saj në të gjitha fushat e në mënyrë të veçantë në trashëgiminë kulturore. Ajo ka nxjerrë poetë, këngëtarë e rapsodë që në çdo kohë kanë përçuar vlera të mëdha artistike, duke u bërë kështu një burim i pashtershëm për trashëgiminë kulturore të zonës në hapsirat e kulturës kombëtare, por dhe një promotor për ta përcjellur atë tek brezat e ri.

Për të pasqyruar me vërtetësi kontributin e artistëve malësorë në kulturën shqiptare, mund të përmendim: të paharrueshmin, Artistin e Merituar Sali Mani, si rapsod i papërsëritshëm, poetin Dodë Kaçaj, rapsodin Jonuz Delaj, virtuozin Lukë Kaçaj, por dhe artistët e përmasave kombëtare Angjelin Përlocaj, Shaban Bercaj, Rrok Gjellaj, Arben Delaj, Violeta Deda, Hanë Nikprelaj, Gjyste Vulaj etj. Ata janë shumë dhe secili prej tyre meriton vlerësimin më të madh, por në këtë shkrim unë do të ndalem më gjatë për këngëtarin e mirënjohur tuzian Nikollë Nikprelaj.

Në afirmimin, pasurimin dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore, vlerave universale të popullit shqiptar, të kulturës tonë kombëtare, një kontribut të çmuar ka dhënë edhe këngëtarin i mirënjohur Nikollë Nikprelaj.

Nikollë Nikprelaj është një nga këngëtarët më të pëlqyer në të gjitha trojet shqiptare. Ai njihet për zërin e tij të mrekullueshëm dhe repertorin me këngët e tij të shumta, si një ndër ikonat e muzikës dhe këngës popullore shqiptare. I ka kënduar maleve, Kreshnikëve të Malësisë, historisë së lavdishme të popullit të kësaj treve, heronjve kombëtarë dhe të zonës së Malsisë, jetës së Malsisë në përgjithsi, Kosovës, bukurisë natyrore, bukurisë njerëzore, intelektualëve dhe vlerave të tyre të veçanta në mrrëdhënie me Malësinë. U ka kënduar mërgimtarëve, rinisë, shpresës, bëmave të Çun Mulës, etj. Ka marrë pjesë edhe në ngjarjet familjare, gëzimet, fejesat, dasmat, por edhe në koncerte të ndryshme që janë organizuar jo vetëm në vendlindje, por edhe në Shqipëri e Kosovë.

Unë udhëtova drejt Tuzit me shumë dëshirë e përgjegjësi për të realizuar një shkrim për qytetarin dhe këngëtarin kaq të dashur e të mirënjohur të këtij qyteti, për Nikollë Nikprelaj, të cilit, përveç të tjerave, i mora edhe një intervistë për ta botuar në gazetë.

Z. Nikollë ju jeni pjesmarrës në disa festivale kombëtare, ku suksesin e keni arritur që në festivalin e parë "Akordet e Kosovës" në vitin '85 në Prishtinë, ku

edhe jeni nderuar me dy çmime të para, me çmimin e "Jurisë" të asaj kohe dhe me çmimin e "Publikut". Mund të na tregoni diçka rreth vazhdimësisë së pjesmarrjes suaj në festivale?

Po, mund të përmend Festivalin Kombëtar të Këngës Popullore Qytetare të organizuar në Tiranë nga RTSH, me një këngë të kompozitorit të njohur Edmond Zhulali dhe një këngë me tekst të cilin e kam shkruar vetë. Për herë të parë mora pjesë në një festival të tillë ku pata emocione të papërshkruara, duke u ndjerë shumë i nderuar në këtë festival, pasi përfaqësoja Malin e Zi.

Në vazhdim të bisedës që bëmë me Nikollën, ndër të tjera ai më tregon se kënga shqiptare e ka motivuar shumë, pasi edhe aktivitetet bëhen të përbashkëta, duke u trajtuar si i barabartë me një shkodran, apo nga ndonjë qytet tjetër i Shqipërisë. "Fatmirësisht, thotë Nikolla, po unifikohen arti dhe kultura në përgjithësi, çka është në të mirën e artit dhe të Kombit".

Ju jeni bërë pjesë e televizioneve në Shqipëri e Kosovë. Keni organizuar disa koncerte të ndryshme, jeni i pranishëm, i dashur, i thjeshtë, virtuoz, jeni vetvetja. Më shumë se kushdo tjetër i keni dhënë jetë, shpresë dhe gjallëri vendlindjes tuaj, duke u bërë kështu një vlerë e Kombit tonë. Çmund të na thoni rreth karrierës suaj artistike?

Tani më u bënë shumë vite karrierë! Ne shqiptarët jashtë trojeve etnike nuk e kemi patur fatin e njëjtë me ata brenda trojeve përsa i përket artit. Arti në Shqipëri zhvillohej brenda institucioneve dhe talentët zbuloheshin dhe përkraheshin. Ne jashtë ishim në mëshirën e fatit. Me amatorët talentë nuk merrej askush. Këndonim këngë të kolegëve tanë nga Shqipëria. Pra nuk kishim krijimtari tonën origjinale. Shumë prej nesh nisëm të krijojmë këngë për veten të shtyrë nga halli dhe shumë prej nesh edhe ja arritëm të bejmë krijimtari origjinale, bile me sukses. Ja për shembull unë i kam bërë pothuajse të gjitha këngët e mia vetë! Bëhet fjalë për vitet e kaluara se tanimë u hapen kufijt dhe u bëmë një përsa i përket artit dhe kulturës. Për karrierën time artistike ka shumë komente, pasi ajo ka qenë dhe vazhdon të jetë shumë e suksesshme. Në çdo event në skenë dhe televizion përiqem që të këndoj live.

Sukseset janë evidente si në drejtim të cilësisë muzikore po ashtu edhe të nivelit të teksteve, duke u pasqyruar kështu këto

vlera në interpretimin brilant në çdo skenë ku ju keni debutuar. A mund të na tregoni ku keni përformuar për herë të parë?

Për herë të parë kam përformuar në aktivitetet e shkollës fillore, por fillim të karrierës e quaj shkuarjen time në Kosovë në vitin 1983. Hapat e parë në Kosovë i mora në shoqatën e studentëve "Ramiz Sadiku" ku u njoha edhe me legjenden e muzikës Qamilin e Vogël, i cili me angazhoi dhe përkraku gjatë viteve të para të karrierës.

Kështu filloi për ju rruga artistike ku



me interpretimet brilante morët famë jo vetëm në Mal të Zi e Kosovë, por edhe në të gjitha trevat shqiptare, duke u bërë kështu i dëshirueshëm edhe nëpër Europë e më gjërë, ku jetojnë shqiptarë. Përveç trevave shqiptare ku keni përformuar më tej?

Po, kam përformuar në të gjitha vendet e Europës, si në Gjermani, Francë, Zvicër, Belgjikë etj, si dhe në vendet skandinave Norvegji, Danimarkë e Suedi, deri në Amerikë dhe Australi.

Çfarë ka qenë diçka interesante në karrierën tuaj?

Interesante dhe e paharruar në karrierën time ka qenë kur mora ftesën të shkoj në Australi me Radio-Televizionin e Kosovës dhe kërkova leje nga Akademia ku studjoja, por mora përgjigje negative. Mirëpo Australia nuk refuzohej dhe vendosa të shkoj. Kur u ktheva me shpëtoi profesori im Rexhep Ferri nga përjash-timi nga Akademia.

Aktiviteti juaj është shumë i larmishëm. Repertori i këngëve tuaja ka bërë

që ata të jenë gjithmonë pjesë e gëzimeve familjare, aktiviteteve rinore, diskove prestigjioze dhe televizioneve më në zë që kanë në progamacionin e tyre muzikën e bukur shqiptare. Kryesisht në sezonin e verës ku jeni më i angazhuar?

Gjatë sezonit veror jam i angazhuar pothuajse nëpër të gjitha trojet shqiptare, përjashtuar Jugun e Shqipërisë. Pandemia na privoi nga të gjitha aktivitetet muzikore. Për fat të mirë unë kam një studio në shtëpi dhe kam punuar pa pushim.

Kam dhënë shumë intervista nga shtëpia përmes skype. Në sezonin e verës në dasma ftohëm rregullisht në të gjitha qytetet e Kosovës si dhe në Shqipëri. Gjithashtu edhe në Ulqin, Tuz, Preshev, Bujanovc, Tetov, Gostivar, Kumanov, etj.

Po në festat e fundvitit a ju ka qëlluar që të jeni i pranishëm në familjen tuaj?

Që në fillimet e mia, parësisht nga dëshira e mirë, nuk kam pasur rastin të festoj dhe të përformoj së paku një natë të ndërrimit të viteve në Tuz, pra Vitin e Ri, sepse bashkëatdhetarët e mi që jetojnë jashtë, e kishin më të domosdoshme që unë të isha pranë tyre si këngëtar, por me statusin e vëllait që feston mes vëllezërish.

Përveç talentit, i cili është dhe starti i këtij rrugëtimi artistik, një ndër elementët e suksesit është edhe bashkëpunimi me kompozitorë të shquar shqiptar nga Kosova dhe Shqipëria. A mund të na thoni diçka rreth bashkëpunimeve tuaja?

Bashkëpunimet e shumta kanë filluar shumë vonë pasi që krijoja vetë për vehten. Po përmendi vetëm disa, pasi numri është i shumtë. Prej këngëtarëve: Ilir Shaqiri, Shkurte Fejza, Shaqir Cervadiku, Mahmut Ferati etj. Kompozitorët: Edmond Zhulali, Valton Beqiri, Shpëtim Saraçi, Alfred Kaçinari, Florent Boshnjaku, Ilir Berani etj. Tekstshkruesit: Gjokë Beci, Agim Doçi, Faruk Tasholli Ramazan Çeka, Gjovalin Lumaj, etj.

Në eventet kulturore e artistike që televizionet organizojnë herë pas here a jeni vlerësuar me çmime?

Po, jam vlerësuar shumë herë, por unë zakonisht veçoj Festivalin "Akordet e Kosovës" në vitin 1985 ku u vlerësova me dy shpërblimet e para, atë të jurisë profesionale, kryetare e së cilës ishte Nexhmije Pagarusha si dhe shpërblimi i parë i publikut! Vlen të theksohet se në këtë festival merrnin pjesë këngëtarët më në zë të Kosovës! Atë vit isha i vetmi këngëtar i pa afirmuar dhe po ashtu i vetmi ku



për mua ishte eksperiencia e parë që të performoj me formacion të madh të orkestrës. Kjo fitore imja bëri bujë në Kosovë edhe për faktin që festivalin e fitoi një këngëtar i panjohur, pasi që deri në këtë festival paraqitjet e mia nëpër skena ishin vetëm me instrumenta folklorike.

E veçanta juaj është se, përveçse përformoni live, njëkohësisht jeni i njohur edhe si instrumentist i talentuar, pasi jeni një artist që pothuajse i zotëroni të gjithë instrumentët muzikorë, si lahutën, fyellin, çiftelinë etj, duke mos anashkaluar edhe tekstet që ju shpesh herë i bëni vetë, çka përbën një veçori shumë pozitive, në raport me këngëtarë të tjerë, Ç'mund të na thoni më konkretisht?

Siç e thash edhe më parë pothuajse të gjitha tekstet dhe muzikën e këngëve të mia ndër vite i kam bërë vetë. Tani kohen e fundit kam kërkuar ndihmë përse u perket teksteve, nga ju Ramazan e jo vetëm. Të këndosh live është meritë, pasi nxjerr në pah talentin e vërtetë. Nga ana tjetër, tingëllimi e orkestrës kur është perfekt. Për tekstet mund të them një mendim të saktë se ka edhe vështirësi nëse nuk i ke lexuar si poezi më vete, por kjo gjë tek unë ka qenë një kërkesë për arritjen e suksesit, pasi në disa raste tekstet e këngëve të mia, ashtu siç e thatë edhe ju, i kam bërë vetë. Përse i përket krijimtarisë muzikore, pra kompozimeve, vazhdimisht kanë qenë në nivelin e duhur. Pra kam arritur më së miri që të përshtas vokalin tim me krijimtarinë muzikore dhe letrare.

Nikolla gjithmonë ka pasur pasion për këngën. Ai filloi të këndoje që në shkollën fillore në klasën e gjashtë, por si profesionist në vitet e vonshme të rinisë. Nikolla po ashtu ka qenë pjesmarrës i grupit folkloristik "Besa Trieshit" dhe më vonë ka drejtuar grupin artistik "Malësia", duke fituar disa herë vendin e parë në koncerte dhe festivale, si në Mal të Zi, Kosovë dhe Shqipëri.

Ai ka fituar një popullaritet të gjërë, i cili shquhet për individualitetin artistik, që e bën të dallueshëm prej të tjerëve. Fama dhe vlerat e këtij këngëtar, mori trajtën e një bilbili, që me zërin e tij të bukur nuk njeh kufinj, sepse kënga e Nikollë Nikprelës ka vite që është e pranishme në të gjitha trevat shqiptare. Ai me galerinë e këngëve të tij ka dhënë një kontribut të madh në ruajtjen dhe transmetimin tek brezat e ardhshëm të pasurisë së madhe artistike dhe shpirtërore të Trevës së Malësisë, si dhe për ta përjetësuar madhësitinë e kësaj vlere shpirtërore.

Cili është kontributi juaj në ruajtjen dhe transmetimin tek brezat e ardhshëm për vlerat artistike dhe kulturore?

Mund të them se kam qëndruar pranë shqiptarëve me zemër e mendje dhe me këngën time kam nxjerrë në dritë figurat e shquara të Malsisë së Madhe, Tuzit, Rrethinave dhe qytetit të Shkodrës me një histori të lashtë dhe legjendare, për të cilat kurrë nuk jam kursyer.



Në krijimtarinë e repertorit tuaj si këngëtar shumë planesh, cilat janë këngët më të njohura?

Në repertorin e këngëve të mia, ndër këngët më të njohura mund të përmend: "Oj lulja e Malsisë", hiti i parë, si dhe "Jem Ilira jem Teuta", "Pse jem toskë e pse jem gegë", "Kaçurrelja", "Jam një djalë fukara", etj.

Cila është kënga më e re që keni realizuar?

Në rrjedhën e krijimtarisë sime të re

kam realizuar edhe një këngë titulluar "O tupan" me tekstin tuaj dhe muzikën e ka bërë kompozitori Edmond Zhulali "Mjeshtëri i Madh", por në projektet e mia për të ardhmen kam disa ide. Kam edhe tre këngë të cilave do ua bëj vedeoklipet. Nuk do doja që të zbuloj diçka më shumë rreth këtyre këngëve, sepse mendoj se është më mirë të ruhet kureshtja e adhuruesëve të mi.

Në të vërtetë puna e Nikollë Nikprelës si këngëtar i shquar ka shkëlqyer për afro

40 vjet në festa e dasma në Tuz, Ulqin, Kosovë e Shqipëri, por edhe në kurbet në Amerikën dhe Australinë e largët, duke qenë motivi, krenaria dhe frymëzimi i Nikollës, Atdheu dhe Kombi. E them me bindje se Nikolla ka kontribuar për Kombin tonë e në veçanti për Trevat Veriore të Atdheut, duke treguar fuqishëm mirënjohje e respekt për këngën dhe artin shqiptar.

Këtë ai e manifestoi edhe këtë fundvere me dy koncerte madhështore që u ndoqën nga mijëra spektatorë në venlindjen e tij në Tuz, ku kishin ardhur nga gjithë trevat shqiptare, nga Europa, Amerika e Australia, dashamirë e fansa të tij që i mbyllën në mënyrë kaq të bukur pushimet e tyre në Atdhe.

Krahas performancës së këtij këngëtar virtuoz, në skenë u ngjit edhe këngëtar nga Prishtina Gold AG, i cili u prit me ovacione nga spektatorët e pranishëm. Performanca e orkestrës që shoqëronte këngëtarin Nikollë Nikprelaj ishte në nivelin më të lartë artistik dhe ekzekutiv, pasi instrumentistët Samir Beqaj, Indrit Kodraliu, Arsid Çeka dhe Albin Nikprelaj janë vetë muzikantë të talentuar dhe virtuoz.

Unë pata fatin t'i ndiqja nga afër këto dy koncerte, të njehsha edhe më gjërë veprimtarinë artistike të Nikollë Nikprelës.

Si qershia mbi tortë u paraqit para spektatorëve Albini, djali i Nikollës, i cili performoi si këngëtar dhe instrumentist, duke premtuar se do të ndjek rrugën e atit.

**Ramazan ÇEKA,**  
Gusht 2021





# GEGAJT E SHLLAKUT



Shtrirja gjeografike e fshatit Gegaj, në Njësinë Administrative Shllak, këtë vit është vizituar nga qindra mijëra turist vendas dhe të huaj. Pjesa liqenore e Shllakut bëhet nepermjet lundrimit me varka ku përveçse bukurive natyrore që ofron gjatë udhëtimit ka edhe shumë shpella karakteristike të ndryshme. Shpella më e veçantë është shpella e pëllumbave ku lehtësisht mund të lundrohet me varka në brendësinë e saj. Pak metra më tutje ndodhet fshati piktoresk Gegajt e Shllakut. Lundrimi nepër liqenin e Vau Dejes për në zonën e Shllakut behet nga Rragami që ndodhet 15 km nga qyteti i Shkodrës ose 15 minuta me makinë. Nisja bëhet nga Bar restorant "Zemra e Ballkanit". Ky restorant përveçse ushqimit bio dhe shumë të shijshme, ofron edhe udhëtime me varka për në zonën e Shllakut.

Shpella e pëllumbave në fshatin Gegaj të Shllakut ndodhet në buzë të liqenit të vau Dejës dhe është vizituar nga mijëra vizitor vendas dhe të huaj. Kjo shpellë është shumë e veçantë dhe një ndër të paktat në Shqipëri që është e



## REDAKSIA

Kryeredaktore: **LUIGJ SHYTI**

Prelë Milani, Lazer Stani, Roza Pjetri, Lazer Kodra, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja, Age Martini, Klodjana Serraj, Vilsan Peshkaj, Marjan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziçi, Gazper Marku, Mark Gjeka.

Mundësoi Botimin:  
**Tomë Arra**